

Hazir Haziri Silva Nini Zeni Ballazhi  
**Libër për mësuesin/en**


**Edukatë figurative**

**1**

**Libër për mësuesin/en**

**Edukatë figurative**

**1**



ISBN: 978-9951-786-87-4



9 789951 786874

**BOTIME**

**pegi**

Silva Nini

Hazir Haziri

Zeni Ballazhi

# **LIBËR PËR MËSUESIN/EN EDUKATË FIGURATIVE 1**

Për klasën e parë të arsimit 9-vjeçar

**BOTIME**



Prishtinë, 2023



## BOTIME



Drejtoi botimin: Arlinda RRUSHI  
Recensentë të MASHTI-t:  
Korrektore letrare: Oriada Dajko  
Paraqitja grafike: Aida ÇELA  
Kopertina: Elidor KRUJA  
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë  
ISBN: 978-9951-786-87-4

© Botime Pegi sh.p.k, dega në Kosovë, gusht 2023

Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

---

**Botime Pegi:** cel: +355 069 40 075 02;

**e-mail:** botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al

**Sektor i shpërndarjes:** cel: +355 069 20 267 73; 069 40 106 88;

**e-mail:** marketing@botimepegi.al

**Shtypshkronja Pegi:** cel: +355 069 40 075 01;

**e-mail:** shtypshkronjapegi@yahoo.com

---

## HYRJE

### 1.2 Çfarë synon ky libër?

Qëllimi i këtij libri është t’i orientojë dhe t’i ndihmojë mësuesit/et që japin mësim në klasën e parë, për të përmbushur synimet e kurrikulës së edukatës figurative, për ndërtimin e kompetencave lëndore dhe kyçe të nxënësit/et e klasës së parë, për të planifikuar dhe realizuar detyrat e tyre si mësime mësimdhënëse të kësaj lënde, në përputhje me dokumentet zyrtare e me fazat nëpër të cilat kalon mësimdhënia.

### 1.3 Çfarë përmban ky libër?

Ky libër është konceptuar në përputhje me draft-programin e klasës së parë, të shkallës së parë të lëndës “Edukatë figurative”.

Ky libër merr përsipër:

- të sqarojë çdo mësues/e të edukatës figurative në çështjet e planifikimit ditor që lidhen me njohuritë dhe veprimtaritë në librin e nxënësit/et, dhe me fletoren e punës; të metodologjisë dhe të vlerësimit që duhet të zbatohet çdo mësues/e në lëndën e tij;
- të prezantojë mënyrën se si duhet të përdoren njohuritë, veprimtaritë dhe rubrikat e librit të nxënësit/et nga vetë mësuesi/ja në lëndën e edukatës figurative;
- të udhëzojë për format e reja në lidhje me planin ditor dhe situatat e të nxënësit, me të cilat duhet të punohet mësuesi/ja gjatë vitit shkollor. (theksojmë këtu se: “**Plani mësimor** për fusha dhe shkallë të kurrikulës”, “**Plani vjetor** për fusha të kurrikulës”, “**Plani dymujor** për fusha të kurrikulës” dhe “**Plani javor** për fusha të kurrikulës” hartohen nga mësime mësimdhënësit e fushës/fushave të kurrikulës.) Ky libër në parim jep, ofron ose sugjeron modele, por nuk i dikton ato. Çdo model krijohet mbi një bazë të caktuar të nivelit të klasës ku mësuesi/ja jep mësim. Realiteti në çdo klasë, mund të sugjerojë modele të ndryshme, për tema të caktuara.

### Metodologjia e përdorur në ndërtimin e temave/njësive mësimore

Tri aspektet e planifikimit kanë të njëjtën rëndësi për mësuesin/en: **përmbajtja e programit, filozofia** mbi të cilën ngrihet kjo përmbajtje dhe **planet mësimore** të cilat e bëjnë këtë filozofi dhe përmbajtjen e programit konkrete dhe të realizueshëm. Tri konceptet kryesore të programit janë të integruara në librin e nxënësit/et. Ndërthurjen e temave mësimore dhe të koncepteve na e orienton edhe vetë programi. Nëse një njësi mësimore i përket gjuhës dhe komunikimit artistik, si dhe përmban njohuri mbi elementet e artit, njësi mësimore më pas mund t’i përkasë një njohurie të krijimtarisë dhe performancës artistike, por të ngjashme dhe që rikonfirmon njohurinë e mëparshme. P.sh., njohuria e vijës si element i artit (që i përket gjuhës dhe komunikimit artistik) pasohet nga njohuria për vizatimin (që i përket krijimtarisë dhe performancës artistike) e më pas pasohet nga modelimi i vijave me letër (që i përket krijimtarisë dhe performancës artistike). Në këtë mënyrë, njohuritë mbi elementet përforcohen nëpërmjet përsëritjes, por nxënësit/et marrin njëkohësisht edhe njohuri të reja mbi teknikat dhe mënyrën e përdorimit të elementeve të artit. Koncepti i katërt “Çmuarja dhe vlerësimi estetiko-artistik” është pjesë e integruar në metodologjinë e mësime mësimdhënies për çdo orë mësimore. Ky koncept është shumë i rëndësishëm për vlerësimin veprave të artit, vlerësimin e punimeve të shokëve dhe shoqeve, por edhe për vetëvlerësimin. Ky koncept është zhvilluar në dy njësi mësimore. Në të parën, nëpërmjet të cilës nxënësit/et njihen me karakteristikat e veçanta të çdo artisti në punë, si dhe se si ata e shohin mjedisin, duke e vlerësuar këtë si diçka shumë të rëndësishme në krijim. Nëpërmjet këtyre njohurive, ata do të kuptojnë dhe vlerësojnë më shumë origjinalitetin e tyre e të shokëve, si dhe do të rrisin vetëvlerësimin në krijim. Njësi e dytë mësimore është një shembull i analizës dhe krahasimit midis dy veprave të artit. Kjo njësi mësimore shërben edhe si shembull për njësi të tjera mësimore që mund të planifikohen nga mësuesi (qoftë si orë më vete, por edhe brenda një njësie tjetër mësimore).

Imazhet nga natyra dhe mjedisi përreth janë pjesë e rëndësishme e metodologjisë nëpërmjet kujtesës pamore, për të ndërtuar edhe situatat e të nxëniet që mbështeten në njohuritë e tyre të mëparshme. Përdorimi i imazheve të veprave të artit është pjesë e rëndësishme e metodologjisë, jo vetëm për të krijuar situatën e të nxëniet, por edhe për të kuptuar më thellë njohuritë e ndryshme. Përveç përdorimit të imazheve të artit për të ilustruar njohuritë si të “Gjuha dhe komunikimi artistik” apo “Krijimtaria dhe performanca artistike”, ato janë përdorur edhe të “Relacioni art-shoqëri” në kontekstin historik dhe informues mbi veprën dhe artistin.

Njësitë mësimore përfshijnë edhe integrimin e fushave të tjera në kurrikulë, siç është: Matematika, Shkencat natyrore, Gjuha dhe komunikimi, Shkencat shoqërore, Shoqëria dhe mjedisi etj.; në këtë mënyrë, ju mund t’i integroni këto njësi mësimore në kurrikulën e përgjithshme. Për shembull, tema mësimore “Ngjyra” që i përket njësisë mësimore “Flutura dhe ngjyrat”, përveç njohurisë mbi përzierjen e ngjyrave, përmban edhe njohurinë për simetrinë. Ju mund ta lidhni këtë temë me njësinë mësimore të matematikës mbi simetrinë, ose me shkencat e natyrës me njohurinë mbi insektet.

Nëpërmjet njësisë të ndryshme mësimore, nxënësit/et pasurojnë fjalorin, i cili bëhet i kuptueshëm dhe i qëndrueshëm kur njohuritë përsëriten në disa njësi mësimore dhe shoqërohen me veprimtari. Këtë fjalor, nxënësit/et mund ta përdorin në situata të ndryshme problem-zgjidhjeje edhe në lëndët e tjera.

## Metodologjia për zhvillimin e lëndës së edukatës figurative

Mësimdhënia në edukatën figurative synon gjithëpërfshirjen, motivimin, barazinë në të gjitha aspektet, si dhe bazohet në mësimdhënien dhe mësimnxënien bazuar në kompetenca; mësimdhënien me në qendër nxënësin/en; si dhe mësimdhënien e nxënien e integruar.

Nxënësit/et e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj.

Planifikimi dhe përzgjedhja e strategjive dhe metodave të mësimdhënies në mësimin e edukatës figurative mban parasysh:

- **kompetencat kyçe;**
- **ndërtimi i çdo njohurie dhe i çdo aftësie** mbështetur në ato të mëparshmet;
- **veprimtari praktike krijuese** në edukatën figurative, brenda dhe jashtë klasës, të cilat lidhin konceptet pamore me situata të jetës reale;
- **mjete dhe materiale** konkrete didaktike dhe ato të teknologjisë;
- **krijimi i qëndrimit pozitiv** ndaj lëndës së edukatës figurative dhe përdorimi i saj përgjatë gjithë jetës;
- **bashkëveprimi mësues-nxënës** gjatë procesit mësimor, duke qenë plotësues të njëri-tjetrit.

Mësimdhënës të caktuar përdorin më shumë demonstrimin, të tjerë ligjërimin, reflektimin, diskutimet etj., por ka të atillë që përqendrohen më shumë te përvoja e vëzhgimi duke inkurajuar dhe drejtuar nxënësit/et te kurioziteti ndaj natyrës.

Puna nëpërmjet vëzhgimit, ndihmon zhvillimin e vetëdijes vizuale dhe aftësinë për të krijuar, si dhe vlerësuar artin në mënyrë individuale. Përvoja e punës me materialet dhe teknikat e artit është e rëndësishme për të arritur rezultatet e dëshiruara të të nxëniet. Sigurisht ato kërkojnë një përgatitje shumë të mirë të mësuesit. Të udhëheqësh klasën përmes **zbulimit** është metoda më e përshtatshme për lëndën e edukatës figurative. Praktikimi i disa aftësive, si: përdorimi i gërshërëve (për ciklin fillor), kërkojnë një metodë më të drejtpërdrejtë.

### Metoda e zbulimit inkurajon nxënësit/et:

- Të zbulojnë mundësitë shprehëse të materialeve dhe teknikave për një qëllim të caktuar dhe të eksperimentojnë me to;

- Të njohin ngjyrën, formën, sipërfaqen etj., në mjedisin rrethues dhe të pëlqejnë interpretimin e tyre, sepse e shohin në mënyrë individuale;
- Të shprehin aspektet më të rëndësishme të jetës së tyre në aspektet figurative.

Në udhëzimet e tij, mësuesi/ja përdor **motivimin** nga ambienti, nxit nxënësin/en dhe monitoron progresin e tyre, diskuton me ta punët e kryera dhe, nëse është e rëndësishme, kur puna ka mbaruar bën sugjerimet e nevojshme.

Disa nga format e punës apo metodologjitë të cilat duhet të udhëheqin mësuesit/et gjatë punës së tyre janë edhe:

- eksperiencia dhe imagjinata e nxënësve;
- përdorimi i mjeteve dhe teknikave si nxitje;
- puna përmes vëzhgimit dhe kuriozitetit;
- përdorimi i veprave të artistëve figurativë ose të nxënësve të tjerë si nxitje.

### **Mbështetja në eksperiencën dhe imagjinatën e nxënësve**

Është shumë e rëndësishme që ndërtimi i njohurive të reja të mbështetet në përvojën e përditshme, reale të nxënësve. Në këtë vështrim, ata shpesh kanë nevojë për disa forma nxitjeje. Përvojat e të parit, të dëgjuarit ose të prekjes mund t'i nxisë ata të shprehen vizualisht në një rrugë personale. Po ashtu, zhvillimi i aftësive vëzhguese ndikon në mënyrën e të shprehurit. Kur tregojnë për përvojat e tyre, nxënësit/et portretizojnë veten, familjen, marrëdhëniet me njerëz të afërm dhe gjërat e përditshme që ata bëjnë. Kjo është shumë e rëndësishme, pasi ata vetë janë të përfshirë dhe gjejnë kënaqësi kur përshkruajnë dhe piketojnë situata të ndryshme që ndikojnë në jetën e tyre. Është shumë e rëndësishme të punohet, duke u mbështetur te vëzhgimi, sepse, vetëm kështu, nxënësit/et nuk do të ndihen në siklet kur të realizojnë krijimin e tyre, pasi e shikojnë vetë nga natyra. Gjithashtu, imagjinata është shumë e rëndësishme në krijimin e punimeve dy dhe tredimensionale, pasi ata shfaqin shumë entuziazëm në këtë fushë.

### **Përdorimi i mjeteve dhe teknikave si nxitje**

Përqendrimi te materialet dhe teknikat është një fillim i rëndësishëm për një orë mësimi. Po aq i rëndësishëm është gjetja e teknikës së duhur për të ilustruar njohuritë e gjuhës dhe komunikimit artistik. Por mund të jenë edhe vetë nxënësit/et që zgjedhin teknikën dhe materialet e duhura për temën mësimore të përcaktuar. Është shumë e rëndësishme që nxënësit/et nga viti në vit të fitojnë përvoja dhe aftësi në përdorimin e materialeve, si dhe të njohin mundësitë e tyre shprehëse. Ata duhet të inkurajohen të flasin për materialet që pëlqejnë më shumë dhe pse.

### **Puna përmes vëzhgimit dhe kuriozitetit**


Nxënësit/et zbulojnë karakteristikat e botës së tyre fizike në dy mënyra: duke i parë e duke i prekur objektet nga natyra dhe nëpërmjet zbulimit të karakteristikave të materialeve të artit. Ata vëzhgojnë dhe zbulojnë elementet e artit, që gjenden në natyrë, si: ngjyrën, vijën, formën dy dhe tredimensionale, teksturën (sipërfaqen), hapësirën etj. Ky vëzhgim dhe zbulim do t'i ndihmojë ata të kuptojnë dhe të shprehen në punimet e tyre të artit. Mësuesi/ja dhe klasa e artit duhet të pajisen me ilustrime, koleksione fotografie të objekteve e të fenomeneve nga natyra për nxitjen e veprimtarisë krijuese të nxënësve.

## Përdorimi i veprave të artistëve figurativë ose të nxënësve të tjerë si nxitje

Të mësosh të “lexosh” për çfarë flet një vepër arti, si është realizuar ajo, cila është domethënia, ndihmon nxënësit/et të kuptojnë dhe vlerësojnë punën e tyre, si dhe të tjerëve. Kontakti i menjëhershëm dhe vlerësimi i objektit të artit ose imazhit mund të jetë një pikë e vlefshme për të filluar mësimin e artit. Kështu, nxënësit/et mund të kenë shumë mundësi për të menduar një sërë temash dhe mënyra punimi, të cilat mund t’i përdorin në punën e tyre. Njohja me stile dhe tradita arti mund t’i ndihmojë ata të krahasojnë interpretimin (punimin) e tyre me veprat ose punime të tjerëve dhe të shohin veten si pjesë e komunitetit të arpunuesve. Një vepër arti mund të përdoret si stimul për imagjinatën krijuese, dhe jo si një pretekst për të imituar e kopjuar.

### **Brainstorming (stuhia mendimesh)**

Mësuesit mund të përdorin *brainstorming*-un si një strategji (metodë) e të menduarit, për të ndihmuar nxënësit/et të gjenerojnë pyetje, ide dhe shembuj dhe të zbulojnë një ide apo një temë qendrore (kryesore). Gjatë aplikimit të *brainstorming*-un, nxënësit/et ndajnë idetë që u vinë në mendje dhe i regjistrojnë këto ide pa bërë gjykime rreth tyre. Mësuesi/ja mund të përdorë këtë metodë gjatë prezantimit të temës (gjatë situatës së të nxënësve), për të përcaktuar atë që nxënësit/et dinë dhe duan (ose duhet) të mësojnë dhe për të orientuar zhvillimin e mësimin dhe reflektimin. *Brainstorming* stimulon të menduarit rrjedhshëm dhe fleksibël, si dhe gjithashtu mund të përdoret për të aftësuar nxënësit/et në zgjidhjen e problemeve artistike.



### **Diskutimi**

Diskutimi është një strategji bashkëpunimi përmes së cilës nxënësit shqyrtojnë mendimin e tyre, reagojnë ndaj ideve, përpunojnë informacionin dhe artikulojnë mendimet e tyre duke i shkëmbyer me njëri-tjetrin dhe me mësuesit. Diskutimi mund të përdoret për të qartësuar konceptet, idetë dhe informacionin. Theksi vihet në bisedën dhe dëgjimin e njëri-tjetrit. Nëpërmjet diskutimit, nxënësit mund të krijojnë lidhje midis ideve dhe përvojës dhe të reflektojnë mbi interpretime të ndryshme.

### **Bisedat**

Bisedat shoqërojnë pothuajse çdo temë që ka të bëjë me njohuritë dhe punën praktike që shoqëron këto njohuri.

Nxënësit duhet të diskutojnë nën udhëheqjen e mësuesi/es për punët e tyre dhe të shokëve si ata kanë përdorur elementet e vizatimit me të cilat janë njohur, si i kanë vënë në shërbim të idesë, si i kanë përdorur elementet e tjera që kanë njohur më parë. Si mund ta realizonin më mirë punën e tyre. Të krahasojnë punët e tyre me atë të shokëve.



Të nxjerrin në pah problemet që iu kanë dalë gjatë punës, si i kanë kapërcyer ato ose si duhet ta përmirësojë punën e tyre për të arritur rezultatin e dëshiruar në punimet e tjera etj.

Të gjitha këto konkluzione, nxënësi/ja duhet t'i nxjerrë me ndihmën e mësuesit/es pasi ai/ajo është udhëheqësi/ja i/e bisedës dhe nxitësi/ja i/e bashkëbisedimit.

### **Vëzhgimet dhe bisedat për to**

Ashtu si bisedat dhe diskutimet mbi punët që shoqërojnë njohuritë e mara mbi gjuhën artistike, edhe vëzhgimi është i rëndësishëm, kjo për faktin se të gjitha elementet e artit si vija, forma, ngjyra, tekstura, hapësira etj., e kanë burimin nga natyra, nga objektet dhe dukuritë e saj; zbulimi dhe studimi i tyre është i lidhur ngushtë edhe me shkencat.

Shumë nga këto elemente dhe dukuri në jetën e përditshme kalojnë pa u vënë re nga syri ynë, prandaj është e nevojshme stërvitja e syrit për t'i parë dhe zbuluar ato. Çdo njeri i percepton këto elemente dhe dukuri sipas mënyrës së vet. Shpeshherë këto vëzhgime e perceptime janë bërë një bazë e fortë për krijimin e veprave të artit e zbulimeve të reja shkencore. Nxitja e vëzhgimit duhet të orientohet nga mësuesit/et në bazë të temave përkatëse.

Nxënësi/ja mund të mbajë një album personal në të cilin të vendosë materialet ilustruese të gjetura nga vetë ai, gjatë vëzhgimeve.

Në bazë të këtyre vëzhgimeve ndërtohet edhe diskutimi në klasë, ku nxënësi në mbështetje të vëzhgimeve të tij dhe materialeve të mbledhura diskuton dhe arrin vetë në njohjen e elementeve (siguron në bazë të udhëzimeve dhe shpjegimeve të mësuesit/es) duke arritur kështu në një perceptim më të thellë.

### **Eksperimenti**

Eksperimentimi është një metodë thelbësore për artin pamor dhe përdoret shpesh për të bërë lidhjen midis konkretes dhe abstraktes. Eksperimentimi kërkon që nxënësit të hetojnë, testojnë, eksplorojnë, manipulojnë, zgjidhin problemet, marrin vendime dhe organizojnë informacione në mënyrë praktike. Eksperimentimi inkurajon gjithashtu nxënësit që të përdorin aftësitë bashkëpunuese në mënyrë efektive në interpretimin dhe komunikimin e gjetjeve.

Eksperimentimi rrit motivimin, mirëkuptimin dhe përfshirjen aktive të nxënësve dhe mund të iniciohet nga mësuesi/ja ose vetë nxënësi/ja.

### **Puna në grup**

Teknikat e punës në grup u mundësojnë nxënësve të punojnë si ekip për të arritur një qëllim të përbashkët: mësimin. Për shembull, një grup nxënësish mund të punojnë së bashku për të krijuar një vepër arti ose për të realizuar një projekt artistik. Përveç produktit përfundimtar të prodhuar nga grupi, një aspekt i rëndësishëm i procesit të të mësuarit bashkëpunues është që çdo anëtar i grupit të shqyrtojë se si grupi funksionon dhe të vlerësojë kontributin e tij ose të saj në procesin e punës në grup. Diskutimet, shënimet dhe vetëvlerësimi janë disa nga mënyrat me të cilat nxënësit mund të reflektojnë mbi procesin e punës në grup dhe pjesën e tyre në të.

### **Kujtesa pamore**

Kujtesa pamore është një proces që shërben për ta bërë një objekt, një ngjarje ose një situatë të dukshme në imagjinatën e nxënësve duke e ndërtuar nëpërmjet përshkrimit me fjalë ose duke përdorur një imazh. Mësuesit mund të përdorin imazhet, gjatë mësimdhënies dhe mësimnxënies, si një ushtrim për kujtesën dhe si një nxitës i rëndësishëm përpara krijimit të punimit. Mësuesit gjithashtu mund të përdorin një sërë stimulimesh pamore (p.sh., ilustrime, fotografi, riprodhime veprash arti, video, objekte reale, grafika) për të ndihmuar nxënësit në krijimin dhe realizimin e punimeve të tyre artistike nëpërmjet teknikave të ndryshme.

### **Hulumtimi i orientuar**

Kjo është një metodë mësimore në të cilën nxënësit përdorin mjetet dhe materialet sipas zgjedhjes së tyre. Mësuesi/ja vëzhgon dhe dëgjon ndërsa nxënësit po eksplorojnë dhe japin udhëzime sipas nevojës, duke përdorur informacionin e mbledhur nga vlerësimi. Për shembull, mësuesi/ja mund të parashtrijë një pyetje, që nxit një mendim më të thelluar ose të prezantojë një fjalor të ri.



## Hulumtimi i lirë

Ky është një aktivitet kyç i mësimdhënies që iniciohet nga nxënësit, duke përdorur materialet artistike në klasë sipas zgjedhjes së tyre. Mësuesi/ja vëzhgon dhe dëgjon si pjesë të vlerësimit të vazhdueshëm ndërsa nxënësit po eksplorojnë (hulumtojnë) lirisht, dhe nuk e drejton eksplorimin, ashtu siç bën gjatë eksplorimit të orientuar.

## Organizuesit grafikë


Organizuesit grafikë mund të përdoren për të regjistruar, organizuar, krahasuar, analizuar dhe sintetizuar informacionet dhe idetë. Ato mund t'i ndihmojnë nxënësit të lidhin njohuritë paraprake me konceptet e reja si dhe konsolidimin e kuptimit të tyre.

Disa nga këta organizues grafikë të përshtatshëm për klasën e parë dhe që janë përdorur edhe në planet mësimore janë: harta e mendimeve (kllasteri) (reflektimi) dhe diagrami i Venit (përdoret gjatë reflektimit).

Gjithashtu edhe teknika e *brainstorming*-ut mund të paraqitet me një organizues grafik, si më lartë.

## Teknika: Diagrami i Venit

Diagrami i Venit është një teknikë, më anë të së cilës evidentohen të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet dy koncepteve. Diagrami i Venit ndërtohet me prerjen e dy a më shumë rrrathëve.



Përdoret kryesisht gjatë fazës së reflektimit. Nëpërmjet tij, nxënësit zbulojnë tipare të përbashkëta dhe veçori dalluese në varësi të specifikave të temës së mësimin, si dhe mbajnë qëndrime personale lidhur me to.

## Teknika: Kllasteri

Kllasteri ose grupimi i mendimeve ose “Harta e mendimeve”, është një teknikë që i nxit nxënësit të mendojnë për të krijuar lidhje midis fakteve. Shërben si një mjet i fuqishëm për fillimin e procesit të të mësuarit, sidomos për ata nxënës që u mungon një dëshirë e tillë.

Hapat për realizimin e kllasterit janë të thjeshta dhe të lehta për t’u mbajtur mend:

- Shkruhet një fjalë në qendër të fletës, (dërrasës së zezë, apo sipërfaqes ku mund të shkruhet).

- Shkruhen fjalë apo fraza që vijnë ndër mend rreth kësaj fjale apo teme të zgjedhur, pa gjykuar rreth tyre.

- Shkrimi i ideve ndërpritet vetëm kur mbaron koha e caktuar. Ndërkohë nxënësit nuk duhet të shqetësohen për gabimet në shkrim apo në shqiptim.

Kjo teknikë mund të përdoret në fazën e evokimit dhe të reflektimit, në të gjitha lëndët dhe me çdo moshë nxënësish. Ajo mund të përdoret për të stimuluar të menduarit, përpara se të studiohet pjesa ose për të bërë përmbledhjen e asaj që është studiuar.

## MODEL I PLANIT VJETOR

Fusha e kurrikulës: Arte

Klasa: E parë

Lëndët e fushës kurrikulare L	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				Kontributi në rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës
	Gjysmëvjetori i parë		Gjysmëvjetori i parë		
	Shtator-tetor 9 orë	Nëntor-dhjetor 8 orë	Janar-shkurt-mars 11 orë	Prill-maj-qershor 9 orë	
Vlerësimi individual dhe analiza e punimeve (1 orë)  Elementet e artit, (prezantimi) (1 orë)  Vija dhe vizatimi (2 orë)  Vizatimi (2 orë)  Forma (t) dhe modelimi (3 orë)	Llojet e ngjyrave dhe teknikat (3 orë)  Ngjyrat (4 orë)  Gjurmët dhe shenjat (tekstura) (1 orë)	Gjurmët dhe shenjat (4 orë)  Forma dhe modelimi (4 orë)  Projekte dhe shembuj (1 orë)  Forma dhe modelimi (2 orë)	Objekte dhe artefakte (2 orë)  Krijues të shquar (2 orë)  Përshkrimi, analiza dhe vlerësimi (1 orë)  Galeri dhe ekspozime (1 orë)  Profesioni im kur të rritem (1 orë)  Planifikime (2 orë)	Komunikues efektiv  I.3, 6, 7  Mendimi kreativ  II.1, 3, 4  Nxënës i suksesshëm  III.1, 2, 3, 4, 7  Kontribuues produktiv  IV. 5, 2, 6  Individ i shëndoshë  V. 5, 7  Qytetar i përgjegjshëm  VI. 2, 4, 6	

**PLANI DYMUJOR: SHTATOR-TETOR**

**FUSHA E KURRIKULËS: ARTE**

**LËNDA MËSIMORE: EDUKATË FIGURATIVE**

**KLASA: I**

**TEMA MËSIMORE: Vlerësimi individual dhe analiza e punimeve**

Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

**I. KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT - KOMUNIKUES EFEKTIV:**

I.3 Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

I.6 Identifikon personazhet (subjektet) kryesore të një (vepre arti) tregimi, drame, filmi, kënge apo loje, që është i përshtatshëm për moshën dhe realizon një subjekt të ngjashëm në punimin e tij.

**III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESSHËM:**

III.1 Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numërorin etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë.

III.4 I jep zgjidhje në mënyrë të pavarur problemës, detyrës së dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.

**REZULTATE E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN 1:**

2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit/et njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse.

1.1 Vizaton, ngjyros, e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e me materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose me temë të caktuar.

4. 2 Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.

**TEMA MËSIMORE: Elementet e artit**

Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

**I. KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT - KOMUNIKUES EFEKTIV:**

I.7 Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse objekte nga mjedisi natyror dhe të krijuara nga njeriu, me të cilin rrethohet; apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe atë e prezanton para të tjerëve.

**II. KOMPETENCA E TË MENDUARIT- MENDIMTAR KREATIV**

II.1 Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njëres nga format shprehëse.

### **III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESHËM**

III.4 I jep zgjidhje në mënyrë të pavarur problemës, detyrës së dhënë, si dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.

#### **REZULTATE E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN 1:**

2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistike nxënësit njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse.

1.1. Vizaton, ngjyros, e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e me materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose me temë të caktuar.

4. 2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.

#### **TEMA MËSIMORE: Vija dhe vizatimi**

Rezultatet e të nxënimit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

### **III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESSHËM**

III.1. Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numërorin etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë.

III.2 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.

III.4 I jep zgjidhje në mënyrë të pavarur problemit, detyrës së dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.

### **IV. KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUES PRODUKTIV**

IV.5 Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

VI.4 Identifikon vlera shoqërore që kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si, p.sh., besimin e ndërsjellë, tolerancën, solidaritetin, respektin, mirësjelljen etj.).

#### **Individ i shëndoshë:**

V.7 Përkujdeset për mjedisin në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).

#### **REZULTATE E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN 1:**

2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit/et njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse.

1.1 Vizaton, ngjyros, e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e me materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose me temë të caktuar.

4. 2 Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.

## **TEMA MËSIMORE: Forma(t) dhe modelimi**

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**

### **II. KOMPETENCA E TË MENDUARIT- MENDIMTAR KREATIV**

II.1 Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njërës nga format shprehëse.

II.3 Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materialet e ndryshme ricikluese duke u mbështetur në imagjinatën e vet.

### **III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESSHËM**

1.1 Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjët, ngjyrat, numërorin etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë.

1.2 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.

III.7 Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.

### **IV. KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUES PRODUKTIV**

IV.2 Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).

IV.5 Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

### **V. KOMPETENCA PERSONALE – INDIVID I SHËNDOSHË**

V.5 Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.

### **REZULTATE E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN 1:**

2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit/et njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse.

1.1 Vizaton, ngjyros, e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e me materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në temë të caktuar.

4. 2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.

## PLANI DYMUJOR: SHTATOR-TETOR

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temën mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare	Burimet
Vlerësimi individual dhe analiza e punimeve	Përjeton në mënyrë individuale vepra të artit dhe i vlerëson sipas tij/saj; Çmon dhe vlerëson imagjinatën kreative të punimit;	1. Çdo piktor është i veçantë 2. Elementet e artit 3. Vijat horizontale, vertikale dhe diagonale 4. Punim me vija me letër punëdore 5. Lloje të ndryshme vijash 6. Mjetet e vizatimit 7. Forma dydimensionale 8. Forma gjeometrike 9. Zbulojmë forma të ndryshme	9 orë	Bisedë Diskutim Lojë me role Brainstorming Diagrami i Venit P Punë në grupe P Punë individuale	Buletini i pjesëmarrjes Portofoli i nxënësit Vlerësim i ndërsjellë	Njeriu dhe natyra, Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Edukatë muzikore, Edukata fizike, sporte dhe shëndeti Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë angleze, Matematikë Çështjet ndërkurrikulare - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - Zhvillimi personal dhe shkathësitë për jetë - Globalizimi dhe ndërvarësia - Edukimi për media	Teksti shkollor Softuerë arsimorë, Imazhe ilustruese CD
Elementet e artit	Krahason me punimet e tjera në klasë. Zbulon elementet e artit dhe i përdor ato në krijim;						
Vija dhe vizatimi	Përdor mjetet artistike për të realizuar punimin nëpërmjet elementeve të artit. Një lloje të ndryshme të vijave dhe i kombinon ato në mënyra të larmishme;						
Vizatimi (modelimi i vijave)	Përdor mjetet artistike për të realizuar punimin me kombinime vijash. Vizaton së paku 2 vizatime me vija të ndryshme;						
Vizatimi	Përdor mjetet artistike për të modeluar punimin me kombinime vijash;						
Format dhe modelimi	Një lloje të ndryshme të vijave dhe i kombinon ato në mënyra të larmishme.						
Forma dhe modelimi	Dallon dhe demonstroi dy shembuj për përbërjen dhe strukturën e formave;						
Forma dhe modelimi	Dallon hapësirat dhe vizaton së paku 2 vizatime në hapësirë të jashtme (natyrë);						

**PLANI DYMUJOR: NËNTOR-DHJETOR**

**FUSHA E KURRIKULËS: ARTE**

**LËNDA MËSIMORE: EDUKATË FIGURATIVE**

**KLASA: I**

**TEMA MËSIMORE: Llojet e ngjyrave dhe teknikat; ngjyrat**

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:**

## **II. KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT-KOMUNIKUES EFEKTIV**

II.1 Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njërës nga format shprehëse.

### **III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESSHËM**

1.1 Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjët, ngjyrat, numërorin etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë.

1.2 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.

III.4 Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.

III.7 Identifikon njohuritë e veta që ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.

## **IV. KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONRTIBUUES PRODUKTIV**

IV.2 Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).

### **V. KOMPETENCA PERSONALE – INDIVID I SHËNDOSHË**

V.5 Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.

### **REZULTATE E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN 1:**

2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit/et njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse.

1.1. Vizaton, ngjyros, e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e me materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose me temë të caktuar.

4. 2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të të tjerëve, duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.

**TEMA MËSIMORE: Gjurmët dhe shenjat**

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:**

### **III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESSHËM**

III.2 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.



III.4 I jep zgjidhje në mënyrë të pavarur problemit, detyrës së dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.

#### **IV. KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUUES PRODUKTIV**

IV.2 Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).

IV.5 Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

#### **REZULTATE E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN 1:**

2 Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik nxënësit/et njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse.

1.1 Vizaton, ngjyros, e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e me materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose me temë të caktuar.

4. 2 Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.

## PLANI DYMUJOR: NËNTOR - DHJETOR

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare	Burimet
Vlerësimi individual dhe analiza e punimeve Forma dhe modelimi Llojet e ngjyrave dhe teknikat Ngjyrat Gjurmët dhe shenjat	Identifikon ngjyrat bazë; Njeh mënyrën e përdorimit të ngjyrave. Përvetëson njohuritë mbi ngjyrën dhe ngjyros së paku 3 punime me ngjyra lapsi; Kupton teknikat dhe ngjyros së paku 3 punime me ngjyra të ujit. Njeh dhe përdor mjetet e ngjyrosjes (ngjyra uji, peneli); Bisedon dhe njeh disa shembuj me ngjyra (p.sh. flutura, ylberi, lulet, kafshët, etj.) Njeh karakteristikat e sipërfaqeve të ndryshme nëpërmjet shtypit të thjeshtë dhe riprodhimi; Realizon 1 shtyp të thjeshtë nga gjurmët e ndryshme (shtyp në letër ose material tjetër praktik me anë të ngjyrave); Njeh dhe të përdor mjetet e ngjyrosjes (pastelat)	1. Ngjyrat primare 2. Ngjyrat dhe emocionet 3. Pikturë me tri ngjyra 4. Ngjyrat sekondare 5. Si të përdorim penelin 6. Pikturë me akuarel 7. Flutura dhe ngjyrat 8. Tekstura	8 orë	Bisedë Diskutim Lojë me role Brainstorming Diagrami i Venit Punë në grupe Punë individuale	Buletini i pjesëmarrjes Portofoli i nxënësit Vlerësim i ndërsjellë	Njeriu dhe natyra, Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Edukatë muzikore, Edukata fizike, sporte dhe shëndeti, Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë angleze, Matematikë, Çështjet ndërkurrikulare - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi I qëndrimeve ekologjike - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - Zhvillimi personal dhe shkathësitë për jetë - Globalizimi dhe ndërvarësia - Edukimi për media	Teksti shkollor Softuerë arsimorë, Imazhe ilustruese CD

**PLANI TREMUJOR: JANAR- SHKURT-MARS**  
**FUSHA E KURRIKULËS: ARTE**  
**LËNDA MËSIMORE: EDUKATË FIGURATIVE**  
**KLASA: I**

**TEMA MËSIMORE: Gjurmet dhe shenjat**

**Rezultatet e të nxënimit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:**

### **III. KOMPETENCA E TË NXËNIMIT – NXËNËS I SUKSESSHËM**

III.2 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.

III.4 Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.

III.7 Identifikon njohuritë që ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.

### **IV. KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUES PRODUKTIV**

IV.2 Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj);

IV.5 Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë;

IV.5 Diskuton në grup për hapësirat e pastra, të sigurta (të shëndetshme) dhe anasjellas në mjedisin që e rrethon dhe tregon të paktën një mënyrë të veprimit për mbikëqyrje apo për përmirësim të gjendjes.

### **V. KOMPETENCA PERSONALE – INDIVID I SHËNDOSHË**

V.5 Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj;

### **VI. KOMPETENCA QYTETARE – QYTETAR I PËRGJEGJSHËM**

VI.2 Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj.

### **REZULTATE E TË NXËNIMIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN 1:**

2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit/et njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse.

1.1. Vizaton, ngjyros e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e me materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në temë të caktuar.

4.2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.

## **TEMA MËSIMORE: forma dhe modelimi**

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:**

### **II. KOMPETENCA E TË MENDUARIT – MENDIMTAR KREATIV**

II.3 Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materialet e ndryshme ricikluese duke u mbështetur në imagjinatën e vet.

II.4 Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre.

### **III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESSHËM**

III.2 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.

III.4 I jep zgjidhje në mënyrë të pavarur problemit, detyrës së dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.

III.7 Identifikon njohuritë që ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.

### **IV. KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUES PRODUKTIV**

IV.2 Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).

IV.5 Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë.

### **REZULTATE E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN 1:**

1.1 Vizaton, ngjyros e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e me materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose me temë të caktuar.

2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit/et njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse.

4.2 Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.

## **TEMA MËSIMORE: Projekte dhe shembuj**

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:**

### **I. KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT – KOMUNIKUES EFEKTIV**

I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.

I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive.

### **III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESSHËM**

III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.

III.7 Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.

#### **IV. KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUUES PRODUKTIV**

IV.5 Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë.

##### **Rezultate e të nxënit të fushës për shkallën 1:**

3.1. Vëren dhe identifikon lloje të ndryshme të arteve.

1.1 Vizaton, ngjyros e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e me materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose me temë të caktuar.

4. 2 Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.

**PLANI TREMUJOR: JANAR-SHKURT-MARS**

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënimit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë e tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare	Burimet
Gjurmët dhe shenjat	Realizon 1 shtyp të thjeshtë nga gjurmët e ndryshme (shtyp në letër ose material tjetër praktik me anë të ngjyrave).	1. Krijimi im me tekstura	11 orë	Bisedë	Buletini i pjesëmarrjes	Njeriu dhe natyra	Teksti shkollor
Forma dhe modelimi	Njeh dhe përdor mjettet e ngjyrosjes (pastelat). Përdor materiale të ndryshme (të lehta) për krijime modelimi (3 dimensionale). Njeh disa nga objektet arkitekturale, qilimat, ornamentet, vazot etj.	2. Tekstura reale 3. Endja e qilimit 4. Kolazhi 5. Teknika e shtypit (I) 6. Teknika e shtypit (II) 7. Teknika e shtypit (III)		Diskutim	Portofoli i nxënësit	Gjuhë shqipe Edukatë figurative Edukatë muzikore Edukata fizike, sporte dhe shëndeti	Softuerë arsimorë Imazhe të ndryshme ilustruese
Projekte dhe shembuj	Përdor materiale të ndryshme (të lehta) për krijime modelimi. Njeh dhe të përdor mjete të modelimit me mjete të lehta aplikuese. Kupton artin e shtypit (grafik) të thjeshtë dhe riprodhimin p.sh. vula, shtypi me patate, libri etj. Njeh dhe përdor mjete të shtypit dhe dizenjimit (lapsa, flamastera, ngjyra, penel, patate, letër, shtresë plastike, trekëndësh, gomë etj.). Kupton dhe tregon vendosjen e formave në hapësirë. Dallon format sipas madhësive dhe largësisë (perspektiva).	8. Forma tredimensionale (trupat) 9. Forma dy- dhe tredimensionale 10. Trupat gjeometrike me plastelinë 11. Hapësira (perspektiva)		Lojë me role Brainstorming Diagrami e Venit Punë në grupe Punë individuale	Vlerësim i ndërsjellë	Shoqëria dhe mjedisi Gjuhë angleze Matematikë Çështjet ndërkurrikulare Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë Globalizimi dhe ndërvarësia Edukimi për media	Cd

**PLANI TREMUJOR: PRILL-MAJI-QERSHOR**  
**FUSHA E KURRIKULËS: ARTE**  
**LËNDA MËSIMORE: EDUKATË FIGURATIVE**  
**KLASA: I**

**TEMA MËSIMORE: Objekte dhe artefakte**

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:**

## **II. KOMPETENCA E TË MENDUARIT – MENDIMTAR KREATIV**

II.4 Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi/ja duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre.

## **III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESSHËM**

III.2 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në një material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/ detyrë që kërkohet prej tij/saj.

## **IV. KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUUES PRODUKTIV**

IV.2 Kontrollon mjetet/materiallet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).

## **REZULTATE E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN 1:**

3.1 Vëren dhe identifikon lloje të ndryshme të arteve.

1.1 Vizaton, ngjyros e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e me materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose me temë të caktuar.

4.2 Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.

## **TEMA MËSIMORE: Krijues Të Shquar**

Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

## **III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESSHËM**

III.1 Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numërorin etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë.

III.2 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/ detyrë që kërkohet prej tij/saj.

1.1 Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit.

III.7 Identifikon njohuritë që ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.



## **VI. KOMPETENCA QYTETARE – QYTETAR I PËRGJEGJSHËM**

VI.6 Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.

### **REZULTATE E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN 1:**

3.3 Emërton disa (së paku 4 krijues) interpretues të njohur të gjinive e zhanreve të ndryshme të krijimtarisë artistike globale e kombëtare.

1.1 Vizaton, ngjyros e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose me temë të caktuar.

4. 2 Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.

### **TEMA MËSIMORE: Përshkrimi, analiza dhe vlerësimi**

Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

## **III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESSHËM**

III.3 Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.

III.7 Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.

## **VI. KOMPETENCA QYTETARE – QYTETAR I PËRGJEGJSHËM**

VI.6 Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.

### **REZULTATE E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN 1:**

4.1 Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjatë bisedës dhe vrojtimit, me lëvizje, mimikë, me mjete shprehëse të tjera etj.

4.2 Çmon dhe vlerëson performancën/krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve me fjalor shumë të thjeshtë (p.sh. ai/ajo këndoi mirë, pastër, më pëlqejnë ngjyrat që ke përdorë, nuk e ke vizatuar mirë formën e topit etj.).

### **TEMA MËSIMORE: Galeri dhe ekspozime**

Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

## **III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESSHËM**

III.3 Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.

## **V. KOMPETENCA PERSONALE – INDIVID I SHËNDOSHË**

V.5 Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.

## **VI. KOMPETENCA QYTETARE – QYTETAR I PËRGJEGJSHËM**

VI.6 Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.

### **REZULTATE E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN 1:**

- 1.1 Vëren dhe identifikon lloje të ndryshme të arteve.
- 1.2 Vëren dhe identifikon llojet e institucioneve artistike.
- 4.2 Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.

### **TEMA MËSIMORE: Profesioni im kur të rritem**

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:**

## **III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESSHËM**

1.1 Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numërorin etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë.

1.2 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.

III.7 Identifikon njohuritë që ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.

## **IV. KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUES PRODUKTIV**

VI.4 Identifikon vlera shoqërore që kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si, p.sh., besimin e ndërsjellë, tolerancën, solidaritetin, respektin, mirësjelljen etj.).

### **REZULTATE E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN 1:**

2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit/et njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse.

1.1 Vizaton, ngjyros e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e me materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose me temë të caktuar.

4. 2 Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.

## PLANI TREMUJOR: PRILL-MAJ-QERSHOR

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësim Dhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë e tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare	Burimet
Objekte dhe artefakte Krijues të shquar Përshkrim, analiza dhe vlerësimi Galeri dhe ekspozime Profesioni im kur të rritem	Njeh dhe dallon objekte të trashëgimisë kulturore (kombëtare dhe të kulturave të tjera). Njeh disa nga objektet arkitekturalë, qilimat, ornamentet, vazot etj. Komenton punimet personale dhe i krahason me punimet e tjera në klasë. Njeh ndonjë krijues (vizatues, piktor, skulptor, arkitekt etj.), të shquar nga vendi dhe bota. Komenton punimet personale dhe i krahason me punimet e tjera në klasë. Përshkruan punimet me shkrim (së paku 2 fjali). largësisë (perspektiva). Komenton dhe krahason vepra të artit dhe punimet e nxënësve; Përjeton dhe vlerëson në mënyrë personale (së paku 2 punime). Çmon dhe vlerëson imagjinatën kreative të punimet. Njeh dhe kupton disa nga institucionet kulturoro-artistike (muzeume, galeri, studio, vende arkeologjike etj.). Realizon një punim për profesionin duke komentuar mënyrën e realizimit. Shpjegon mënyrën e ndërlidhjes së lëndëve me punimin e realizuar.	1. Tradita e poçerisë 2. Mozaiku 3. Lule e diellit sipas Van Gogut 4. Peizazh vjeshte sipas Ismail Lulanit 5. Kulla sipas Muslim Mulliqit 6. Krahasonjmë dy vepra arti 7. Vizitë në studion e piktorit Planifikime (2 orë)	9 orë	Bisedë Diskutim Lojë me role Brainstorming Diagrami i Venit Punë në grupe Punë individuale	Buletini i pjesëmarrjes Portofoli e nxënësit Vlerësim i ndërsjellë	Njeriu dhe natyra Gjuhë shqipe Edukatë figurative Edukatë muzikore Edukata fizike, sporte dhe shëndeti Shoqëria dhe mjedisi Gjuhë angleze Matematikë Çështjet ndërkurrikulare - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - Zhvillimi personal dhe shkathësitë për jetë - Globalizimi dhe ndërvarësia - Edukimi për media	Teksti shkollor Softuerë arsimorë Imazhe që lustronjë njohuritë CD

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 1

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Arte	<b>Lënda:</b> Edukatë figurative	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> I	<b>Klasa:</b> I
<b>Gjuha dhe komunikimi artistik</b> <b>Tema:</b> Vlerësimi individual dhe analiza e punimeve		<b>Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor):</b> - Përjeton në mënyrë individuale i veprave të artit dhe vlerësimi sipastij/saj. - Çmon dhe vlerëson imagjinatën kreative te punimet. - Komenton punimet personale dhe i krahason me punimet e tjera në klasë.	
<b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b> I.6 Identifikon personazhet (subjektet) kryesore të një (vepre arti) tregimi, drame, filmi, kënge apo loje, që është i përshtatshëm për moshën dhe realizon një subjekt të ngjashëm në punimin e tij. I.3 Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatjen prej 3-5 minutash. III.1 Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjët, ngjyrat, numërorin etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë. III.4 I jep zgjidhje në mënyrë të pavarur problemit, detyrës së dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> 1.1. Vizaton dhe ngjyros në mënyrë kreative një temë të caktuar. 4. 2. Çmon dhe vlerëson karakteristikat individuale të krijimit të tij dhe të shokëve të klasës.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Çdo piktor është i veçantë		<b>Fjalët kyçe:</b> artisti është i veçantë, artisti nuk kopjon.	
<b>Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore:</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Bisedon mbi karakteristikat e veçanta të çdo artisti në krijim. - Krijon një pemë reale ose nga imagjinata në mënyrë personale. - Zbulon që çdo artist është i veçantë dhe çdo krijim është ndryshe nga tjetri.			
<b>Kriteret e suksesit:</b> - Vizaton një pemë reale ose nga imagjinata; - Krahason punën e tij me të shokut dhe kupton që çdo punim është i veçantë.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, imazhe të veprave të artistëve, fletë vizatimi, laps, lapsa me ngjyra ose flamastera.		<b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna, Artet.	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:** Kujtesa pamore (bashkëbisedim)

Në fillim, mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se në lëndën e artit do të mësojnë edhe “çfarë bën një piktor/ose artist figurativ”. Çdo piktor e shikon mjedisin përreth në një mënyrë të ndryshme dhe pasi e realizon veprën tij e ndan atë me të tjerët. Në këtë mënyrë, nëpërmjet ngjyrave, formave tërheqin vëmendjen tonë dhe na ndihmojnë t’i shohim gjërat në një mënyrë të re ose më të mirë.

Mësuesi/ja fton nxënësit/et të vëzhgojnë vepra të artistëve figurativë të ndryshëm që kanë pikturuar peizazh me pemë, duke i treguar me radhë. Në fillim tregon ato më realistet dhe nxit nxënësit/et të tregojnë se çfarë kanë paraqitur artistët dhe a iu pëlqen. Mësuesi/ja i pyet për veprat e tjera nëse janë njësoj me njëra-tjetrën. Nëse thonë jo, mësuesi/ja i pyet pse.

**Ndërtimi i njohurive të reja:** punë individuale, hulumtimi i orientuar

Mbas kësaj bisede, mësuesi/ja shpjegon se çdo artist është i veçantë dhe për këtë arsye punimet e tyre edhe pse janë shumë të bukura, janë të ndryshme nga njëra-tjetra.

Mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të vizatojnë një pemë çfarëdo. Pema mund të jetë reale ose nga imagjinata, në stinën e verës, të dimrit, të vjeshtës ose të pranverës.

E rëndësishme është që ajo të jetë pema e gjithsecilit dhe jo ideja e shokut afër. Nxënësit/et mund të zgjedhin vetë mjetin për të realizuar pemën sipas idesë personale.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Kujtesa pamore dhe diskutimi

Kur puna ka mbaruar, nxënësit/et ngrënë lart punimet e tyre për të parë punimet e njëri-tjetrit dhe komentojnë që ata të gjithë kanë bërë një punë shumë të mirë, çdo pemë paraqitet e veçantë. Nëse ka nxënës që nuk e plotësuan detyrën e tyre mund ta plotësojnë atë më një moment tjetër.

**Vlerësimi i nxënësve**

Vlerësimi i nxënësit/et do të fokusohen:

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et u bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

**Detyrat dhe puna e pavarur**

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te fletorja e punës e klasës së parë.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 2

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Arte	<b>Lënda:</b> Edukatë figurative	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> I	<b>Klasa:</b> I
<b>Gjuha dhe komunikimi artistik</b> <b>Tema:</b> Elementet e artit		<b>Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):</b> - Zbulon elementet e artit dhe i përdor ato në krijim. - Përdor mjetet artistike për të realizuar punimin nëpërmjet elementeve të artit.	
<b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b>  II.1 Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njërës nga format shprehëse. III.4 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj. I.7 Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse objekte nga mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe atë e prezanton para të tjerëve.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> 2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit/et njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse. 1.1 Vizaton, ngjyros e modelon me laps, me ngjyra, me letër e materiale të tjera në mënyrë krijuese një temë të caktuar. 4. 2 Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Elementet e artit		<b>Fjalët kyçe:</b> elementet, vija, forma, ngjyra, tekstura, forma tredimensionale dhe hapësira.	
<b>Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Zbulon se gjuha artistike përbëhet nga elementet e artit (vija, forma, ngjyra, tekstura, forma tredimensionale dhe hapësira) dhe rëndësinë e tyre në krijim. - Përdor elementet e artit për të realizuar krijimin e tij/saj nëpërmjet teknikës së grafitit me pastel. - Çmon dhe vlerëson përdorimin e elementeve të artit në krijimin personal dhe të shokëve të klasës. <b>Kriteret e suksesit:</b> - Përdor elementet e artit për të realizuar krijimin e tij/saj. - Përdor teknikën e grafitit me pastel në krijim.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, gjethe të llojeve të ndryshme, fletë vizatimi, pastela.		<b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> Fusha: Shkencat natyrore, Artet (Muzika), Gjuha dhe komunikimi.	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Bashkëbisedim**

Përpara fillimit të mësimit, mësuesi/ja ka gjetur disa gjethë të ndryshme. Gjethet është mirë të jenë të përafërta në madhësi dhe me forma të thjeshta.

Në fillim, mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se në këtë orë mësimore do të njihen me elementet e artit. Është e rëndësishme t’iu shpjegohet nxënësve të klasës së parë, se çdo lëndë ka elementet e saj. Elementet e shkencës janë: oksigjeni, karboni, hidrogjeni etj. elementet e muzikës janë: harmonia, ritmi dhe koha. Gjuha dhe letërsia ka: shkronjat, subjektin (fabulën), renditjen.

**Ndërtimi i njohurive të reja: kujtesa pamore, bashkëbisedim, punë individuale, hulumtimi i orientuar**

Mësuesi/ja tregon dy gjethë të gjelbra me forma të ndryshme. Vizaton në dërrasë një pjesë nga vija përbërëse e secilës formë të gjethes dhe pyet nxënësit/et: A janë vija këto? (Mësuesi/ja shkruan në dërrasë: Vija është një element i artit) Më pas, mësuesi/ja i pyet: Si i dallojmë gjethet nga njëra-tjetra? Përgjigjja është: nga forma. (Mësuesi/ja shkruan në dërrasë: Forma është një element i artit.) Mësuesi/ja pyet: Si e dallojmë një gjethë të vjeshtës? Përgjigjja është: nga ngjyra. (Mësuesi/ja shkruan në dërrasë: Ngjyra është një element i artit.)

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të përshkrijnë me dorë një gjethë dhe për ta kuptuar sipërfaqen e saj më prekje. Nëpërmjet prekjes kuptohet tekstura. Mësuesi/ja shkruan në dërrasë: tekstura është një element i artit. Shpjegon edhe formën tredimensionale ose vëllimin e gjethes edhe pse ajo duket e sheshtë. Këtë gjë e tregon dritëhija mbi gjethen. Gjithashtu, mësuesi/ja shpjegon hapësirën, si një element tjetër i artit. Këtë e tregon nëpërmjet shembullit që objektet ndodhen gjithmonë në një hapësirë të caktuar, qoftë brenda apo jashtë.

Mësuesi/ja i nxit nxënësit/et t’i zbulojnë këto elemente gjatë përdorimit në punimin e tyre. Nxënësit/et kanë marrë me vete disa gjethë. Mësuesi i orienton të vendosin një, dy ose edhe tri gjethë poshtë letrës së vizatimit dhe të ngjyrosin fletën me pastela duke ushtruar forcë. Në këtë mënyrë, ata zbulojnë vijën e konturit, formën, ngjyrën që e kanë zgjedhur sipas dëshirës dhe teksturën e gjethëve. Rezultati i kësaj teknike është i menjëhershëm dhe i thjeshtë për të ilustruar këtë temë.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Teknika e kllasterit, diskutimi.**

Kur puna ka mbaruar, nxënësit/et shpjegojnë mënyrën e realizimit dhe rikujtojnë me radhë elementet e artit. Nëpërmjet teknikës grafike të kllasterit, mësuesi/ja i shkruan ato në tabelë.

**Vlerësimi i nxënësve**

**Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:**

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

**Detyrat dhe puna e pavarur**

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te fletorja e punës e klasës së parë.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**



## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 3

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Arte	<b>Lënda:</b> Edukatë figurative	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> I	<b>Klasa:</b> I
<b>Gjuha dhe komunikimi artistik</b> <b>Tema:</b> Vija dhe vizatimi		<b>Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):</b> - Njih lloje të ndryshme të vijave dhe i kombinon ato në mënyra të larmishme. - Përdor mjetet artistike për të realizuar punimin me kombinime vijash.	
<b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b> III.4. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj. IV.5. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/ komunitet.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> 2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik nxënësit/et njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse. 1.1. Vizaton, ngjyros e modelon me lapsa me ngjyra ose flamastera mbi letër në mënyrë krijuese një temë të caktuar. 4. 2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Vijat horizontale, vertikale dhe diagonale		<b>Fjalët kyçe:</b> vija horizontale, vija vertikale, vija diagonale.	
<b>Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Zbulon në imazhe dhe në mjedisin përreth vijat horizontale, vertikale dhe diagonale dhe i përdor ato në krijim. - Eksperimenton dhe kombinon cilësi të ndryshme (të trasha, të holla, të shkëputura, me ngjyra të ndryshme) të vijave horizontale, vertikale dhe diagonale, nëpërmjet lapsave me ngjyra ose flamasterave. - Çmon dhe vlerëson përdorimin në kombinime të larmishme të vijës në krijimin personal dhe të shokëve të klasës. <b>Kriteret e suksesit:</b> - Vizaton vijat horizontale, vertikale dhe diagonale. - Kombinon në mënyra të ndryshme estetike vija me cilësi të ndryshme. - Përdor mjete të ndryshme të vizatimit për të krijuar vija me cilësi të ndryshme në krijimin e tij/saj.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, imazhe që ilustronë mësimin, fletë vizatimi, formati me tabelën në libër i fotokopjuar, lapsa me ngjyra ose flamastera.		<b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> Fusha: Shkencat natyrore, Matematika, Gjuha dhe komunikimi.	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim**

Nëpërmjet një imazhi që ilustron vijat horizontale, vertikale dhe diagonale, mësuesi/ja fton nxënësit/et t'i identifikojnë ato. Imazhi duhet t'i ketë të qarta llojet e këtyre vijave duke pasur parasysh edhe moshën e nxënësve. Më pas, ata nxiten të identifikojnë këto lloje vijash edhe në mjedisin përreth. Mësuesi/ja thekson që vija është një element i gjuhës artistike.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Eksperiment, punë individuale**

Pasi nxënësit/et kanë bërë gati fletët e vizatimit ose mësuesi/ja ka shpërndarë fletën model të fotokopjuar, mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et të plotësojnë tabelat me llojet e vijave përkatëse. Ai/ajo i udhëzon të përdorin cilësi të ndryshme të vijës si të trasha, të holla, të shkëputura dhe me ngjyra të ndryshme. Ata mund të eksperimentojnë në fillim në fleta duke u bindur për kombinimet e tyre e më pas të plotësojnë tabelat.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi**

Kur puna ka mbaruar, nxënësit/et shpjegojnë mënyrën e realizimit dhe kombinimit të vijave dhe ngjyrave me të cilat eksperimentuan dhe krijuan. Ata çmojnë dhe vlerësojnë shumëllojshmërinë e kombinimeve në punën e tyre dhe të shokëve.

**Vlerësimi i nxënësve**

**Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:**

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

**Detyrat dhe puna e pavarur**

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te fletorja e punës e klasës së parë.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 4

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Arte	<b>Lënda:</b> Edukatë figurative	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> I	<b>Klasa:</b> I
<b>Krijimtaria dhe performanca artistike Tema:</b> Vizatimi (modelimi i vijave)		<b>Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):</b> - Vizaton së paku 2 vizatime me vija të ndryshme. - Përdor mjetet artistike për të modeluar punimin me kombinime vijash. - Njeh lloje të ndryshme të vijave dhe i kombinon ato në mënyra të larmishme.	
<b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b> III.1 Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjët, ngjyrat, numërorin etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë. III.2 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/ aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj. V.7.Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> 2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit/et njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse. 1.1. Ngjyros e modelon me letra me ngjyra mbi letër në mënyrë krijuese një temë të caktuar; 4. 2 Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Punim me vija me letër punëdore		<b>Fjalët kyçe:</b> vija të llojeve të ndryshme (horizontale, vertikale, diagonale, e trashë, e hollë, pingule, e pandërprerë, e ndërprerë, paralele, letra punëdore.	
<b>Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Kujton vijat horizontale, vertikale dhe diagonale. - Zbulon lloje të tjera të vijave sipas kombinimit (pingule, paralele) dhe cilësisë (e hollë, e trashë, e ndërprerë, e pandërprerë). - Krijon duke kombinuar lloje të ndryshme të vijave dhe të cilësisë së tyre nëpërmjet modelimit me letër punëdore. - Çmon dhe vlerëson përdorimin në kombinime të larmishme të vijës në krijimin personal dhe të shokëve të klasës. <b>Kriteret e suksesit:</b> - Kombinon vijat sipas lljit dhe cilësisë. - Përdor lloje të ndryshme të vijave në krijim. - Krijon kombinime vijash nëpërmjet modelimit të letrave me ngjyra.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, fletë vizatimi, letra me ngjyra, gërshtë, ngjitës.		<b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> <b>Fusha:</b> Shkencat natyrore, Matematika, Gjuha dhe komunikimi.	

### Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimitaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

#### Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bashkëbisedim

Mësuesi/ja i fton nxënësit të kujtojnë llojet e vijave me të cilat krijuan një orë më parë. Më pas, mësuesi/ja nxjerr modele të vijave me cilësi të ndryshme (të trashë, të hollë, të pandërprerë dhe të ndërprerë) dhe i pyet: Si mund të jenë vijat? Njëpërmjet imazheve nxënësit/et identifikojnë cilësinë e vijave (Në këtë mënyrë, nxënësit/et kujtojnë dhe përforcojnë njohuritë).

#### Ndërtimi i njohurive të reja: demonstrimi, eksperimenti, punë dyshe

Mësuesi/ja nxjerr imazhe të kombinimit të thjeshtë të vijave (pingule dhe paralele) dhe shpjegon se vijat mund të kombinohen në mënyra të ndryshme. Mësuesi/ja sjell shembuj të këtyre kombinimeve (p.sh., vija vertikale e qëndrimit drejt të njeriut, qëndron pingul me vijën horizontale të dyshemesë. Dy brinjët e katrorit përballë njëra-tjetrës janë paralele etj.).

Pasi nxënësit/et kanë bërë gati mjetet, mësuesi/ja i udhëzon të presin shirita letre me ngjyra të ndryshme dhe me cilësi të ndryshme. Është mirë që mësuesi/ja të demonstrojë radhën e punës dhe ndoshta një punim të gatshëm për udhëzim, që nxënësit/et të qartësohet për atë që do të realizojnë. Më pas duhet ta heqë punimin e gatshëm në mënyrë që të mos ndikojë zgjedhjet e nxënësve. Më pas, nxënësit/et i ngjisin shiritat e prerë të letrës në drejtimin horizontal, vertikal dhe diagonal. Është mirë që mësimi të zhvillohet në grupe dyshe. Në këtë mënyrë, nxënësit/et ndërveprojnë, plotësojnë dhe ndihmojnë njëri-tjetrin. Ata mund të eksperimentojnë me kombinimin e cilësisë së vijave (shiritave) dhe ngjyrave.

#### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi

Kur puna ka mbaruar, nxënësit/et shpjegojnë mënyrën e realizimit me letra me ngjyra dhe kombinimit të vijave dhe ngjyrave me të cilat eksperimentuan dhe krijuan. Ata çmojnë dhe vlerësojnë shumëllojshmërinë e kombinimeve në punën e tyre dhe të shokëve.

### Vlerësimi i nxënësve

#### Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

### Detyrat dhe puna e pavarur

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te fletorja e punës e klasës së parë.

### Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 5

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Arte	<b>Lënda:</b> Edukatë figurative	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> I	<b>Klasa:</b> I
<b>Gjuha dhe komunikimi artistik</b> <b>Tema:</b> Vija dhe vizatimi		<b>Rezultati i të nxënimit të temës (nga plani dymujor):</b> - Njeh lloje të ndryshme të vijave dhe i kombinon ato në mënyra të larmishme. - Përdor mjetet artistike për të realizuar punimin me kombinime vijash.	
<b>Rezultatet e të nxënimit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b> III.1 Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numërorin etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë. III.4 Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrës së dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes. VI.4 Identifikon vlerat shoqërore që kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si, p.sh., besimin e ndërsjellë, tolerancën, solidaritetin, respektin, mirësjelljen etj.).			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> 2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit/et njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse. 1.1. Vizaton, ngjyros e modelon me lapsa me ngjyra ose flamastera mbi letër në mënyrë krijuese një temë të caktuar. 4. 2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Lloje të ndryshme vijash		<b>Fjalët kyçe:</b> vija të llojeve të ndryshme (e shkallëzuar, e pikëzuar, e përdredhur, e harkuar, e valëzuar, e ndërprerë, zigzage, spirale).	
<b>Rezultati/et e të nxënimit për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Zbulon lloje të tjera të vijave (e shkallëzuar, e pikëzuar, e përdredhur, e harkuar, e valëzuar, e ndërprerë, zigzage, spirale) në mjedisin përreth. - Krijon duke përdorur lloje të ndryshme të vijave duke përdorur lapsat me ngjyra ose flamastera. - Çmon dhe vlerëson përdorimin e vijave të shumëllojshme në krijimin personal dhe të shokëve të klasës. <b>Kriteret e suksesit:</b> - Vizaton lloje të ndryshme të vijave me mjetet e vizatimit; - Përdor lloje të ndryshme të vijave në krijim në kontekstin e duhur; - Përdor lapsa me ngjyra ose flamastera për të krijuar vija të shumëllojshme.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, fletë vizatimi, lapsa ose flamastera.		<b>Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> <b>Fusha:</b> Shkencat natyrore, Matematika, Gjuha dhe komunikimi	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			

### **Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim**

Nëpërmjet imazheve të llojeve të ndryshme të vijave (e shkallëzuar, e pikëzuar, e përdredhur, e harkuar, e valëzuar, e ndërprerë, zigzage, spirale), mësuesi/ja i fton nxënësit/et t'i identifikojnë duke i emërtuar ato. Më pas, mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të sjellin shembuj të ndryshëm të këtyre vijave nga natyra dhe mjedisi rrethues (p.sh.: e shkallëzuar: te shkallët; e valëzuar: te dallgët e detit; spirale: te kërmilli etj.)

### **Ndërtimi i njohurive të reja: Eksperimenti, punë individuale**

Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të realizojnë një krijim dekorativ nëpërmjet përdorimit të llojeve të ndryshme të vijave. Një mënyrë e thjeshtë është ndarja e fletës së vizatimit në tetë pjesë të barabarta (Kjo ndarje mund të realizohet në figura gjeometrike të rregullta ose në mënyrë të çrregullt, sipas dëshirës. Por është e nevojshme që mësuesi/ja të japë shembuj. Kujdes! Shembujt nuk duhet të ndikojnë zgjedhjet e nxënësve nëpërmjet kopjimit.). Këta katrorë mbushen me vija të ndryshme që përzgjidhen dhe kombinohen sipas zgjedhja e secilit nxënës. Ata zgjedhin vetë të përdorin lapsat me ngjyra ose flamasterat për realizimin e punimit.

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur: Diskutimi**

Kur puna ka mbaruar, nxënësit/et shpjegojnë mënyrën e realizimit të krijimit dekorativ dhe kombinimit të vijave dhe ngjyrave, me të cilat eksperimentuan dhe krijuan. Ata çmojnë dhe vlerësojnë shumëllojshmërinë e kombinimeve në punën e tyre dhe të shokëve.

### **Vlerësimi i nxënësve**

#### **Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:**

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

### **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te fletorja e punës e klasës së parë.

### **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 6

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Arte	<b>Lënda:</b> Edukatë figurative	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> I	<b>Klasa:</b> I
<b>Krijimtaria dhe performanca artistike</b> <b>Tema:</b> Vizatimi		<b>Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):</b> - Njeh dhe përdor mjetet e vizatimit (laps, lapsa me ngjyra, flamastera, pastela). - Dallon hapësirat dhe vizaton së paku 2 vizatime në hapësirë të jashtme (natyrë).	
<b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b> IV.5. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet; III.1. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/ aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> 1.1. Vizaton, ngjyros e modelon me lapsa me ngjyra ose flamastera mbi letër në mënyrë krijuese një temë të caktuar. 4.2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Mjetet e vizatimit		<b>Fjalët kyçe:</b> lapsa, lapsa me ngjyra, flamastera, pastela.	
<b>Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Njeh karakteristikat dhe përzgjedh mjetet e vizatimit. - Krijon duke përdorur lloje të ndryshme të mjeteve të vizatimit në krijim. - Çmon dhe vlerëson përdorimin e mjeteve të vizatimit në krijim. <b>Kriteret e suksesit:</b> - Përzgjedh mjetet e duhura për të krijuar në vizatim; - Përdor lloje të ndryshme të mjeteve të vizatimit në krijim (lapsa me ngjyra, flamastera, lapsa, pastela).			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, fletë vizatimi, imazhi i një kafshe që u pëlqen, lapsa, lapsa me ngjyra, pastela ose flamastera.		<b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> Fusha: Shkencat natyrore, Gjuha dhe komunikimi	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			
<b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:</b> kujtesa pamore, bashkëbisedim Nëpërmjet llojeve konkrete të mjeteve të vizatimit (lapsi, lapsat me ngjyra, flamasterat dhe pastelat) mësuesi/ja fton nxënësit/et t'i emërtojnë ato. Më pas, ai/ajo i pyet se cila teknikë i pëlqen më shumë, cilën prej tyre kanë praktikuar dhe pse.			



### **Ndërtimi i njohurive të reja: punë individuale, kujtesa pamore**

Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të realizojnë vizatimin e një pjese të munguar të kafshës nëpërmjet kujtesës pamore që kanë për pjesën e munguar. Për këtë, nxënësi/et udhëzohet të plotësojë ushtrimin e librit ose mësuesi/ja ka përgatitur fletët më parë. Është e rëndësishme që nxënësit/et të vizatojnë njëherë njëherë pjesë të munguar duke iu referuar imazhit fillestar dhe anasjellas. Kjo për të ngacmuar kujtesën e tij pamore mbi kafshën dhe për ta ndihmuar atë të kryejë detyrën me sukses. Nxënësit/et vizatojnë pjesën e munguar të kafshës dhe krijojnë mjedisin që e rrethon. Ata e zgjedhin vetë mjetin me të cilin duan ta realizojnë detyrën.

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi**

Kur puna ka mbaruar, nxënësit/et shpjegojnë teknikën që zgjodhën për të realizuar kafshën e tyre me mjedisin përreth dhe shpjegojnë pse e zgjodhën atë teknikë dhe çfarë mjedisi të përshtatshëm zgjodhën për kafshën e tyre.

### **Vlerësimi i nxënësve**

#### **Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:**

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

### **Detyrat dhe puna e pavarur**

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te fletorja e punës e klasës së parë.

### **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 7

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Arte	<b>Lënda:</b> Edukatë figurative	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> I	<b>Klasa:</b> I
<b>Gjuha dhe komunikimi artistik</b> <b>Tema:</b> Format dhe modelimi		<b>Rezultati i të nxënësve të temës</b> (nga plani dymujor): - Dallon dhe demonstroi dyshembuj për përbërjen dhe strukturën e formave. - Dallon hapësirat dhe vizaton së paku 2 vizatime në hapësirë të jashtme (natyrë).	
<b>Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b> II.1. Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta. III.1. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/ aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> 2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit/et njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse. 4.2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Forma dydimensionale		<b>Fjalët kyçe:</b> forma dydimensionale, forma tredimensionale.	
<b>Rezultati/et e të nxënësve për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Dallon formën e sheshtë dydimensionale nga forma tredimensionale me vëllim e objekteve. - Vizaton me vijë formën dydimensionale të objekteve të thjeshtë. - Çmon dhe vlerëson vizatimin e formave të ndryshme të realizuara nga ai/ajo dhe nga shokët e klasës. <b>Kriteret e suksesit:</b> - Vizaton formën e sheshtë dydimensionale/siluetën të objekteve të thjeshta (fruta, vazo, etj). - Përdor lapsin e zi ose lapsa me ngjyrë në vizatimin e siluetës së objekteve.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, fletë vizatimi, objekte të thjeshta nga natyra (shushë, mollë, gotë etj.), laps ose lapsa me ngjyra.		<b>Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> <b>Fusha:</b> Shkencat natyrore, Matematika, Gjuha dhe komunikimi.	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			
<b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:</b> Kujtesa pamore, bashkëbisedim Mësuesi/ja ka përzgjedhur më parë dy ose tri objekte të thjeshta për nga forma dhe ka përgatitur siluetën (formën dydimensionale) me linjë të këtyre objekteve në letra të bardha vizatimi. Përkrah çdo objekti vendos edhe fletën me siluetën e objektit. Më pas, mësuesi/ja pyet: Cili është ndryshimi midis objektit real dhe atij në letër?			

Përgjigjet mund të jenë nga më të ndryshmet, për shembull, në fletë molla është e vizatuar, kurse mollën e vërtetë mund ta prekim; në vizatim shohim mollën vetëm me laps e ajo nuk ka ngjyrë ashtu si në të vërtetë etj. Përgjigjet mund të jenë nga më të ndryshmet e ju mund t'i nxisni ato.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Punë individuale, kujtesa pamore**

Mbasi nxënësit/et mbarojnë me argumentimet e tyre, bazuar në atë çka ata shohin, mësuesi/ja shpjegon se objektet e vërteta janë me vëllim dhe ato ekzistojnë në formën tredimensionale.

**Ne mund t'i prekim dhe të kuptojmë formën e tyre e mund t'i shohim nga të gjitha anët.**

Ndërsa në vizatim, ne shohim vetëm formën e sheshtë dydimensionale të objekteve, ashtu siç shfaqen në këto vizatime. Mësuesi/ja thekson se forma është një element i artit. Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të vizatojnë formën e sheshtë të objekteve të paraqitura në libër. Ajo i këshillon që të realizojnë vetëm formën e objektit, pa detaje. Më pas, mësuesi/ja mund të vendosë disa objekte të thjeshta si model për t'u vizatuar nga nxënësit/et. Nxënësit/et zgjedhin të vizatojnë njërin prej tyre. Ata mund të përdorin lapsin e zi ose një laps tjetër me ngjyrë.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi, kllasteri**

Kur puna ka mbaruar, nxënësit/et shpjegojnë se cilin objekt zgjedhën për të vizatuar dhe si e realizuan formën e objektit nëpërmjet vijës. Ata çmojnë dhe vlerësojnë edhe punën e shokëve të klasës. Nëpërmjet një skeme të thjeshtë të kllasterit, mësuesi/ja shkruan fjalën formë dhe i pyet nxënësit/et: Si e ndajmë atë? Pas përgjigjeve të nxënësve, ai vendos dy degëzimet e saj "forma dydimensionale" dhe "forma tredimensionale".

**Vlerësimi i nxënësve**

**Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:**

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

**Detyrat dhe puna e pavarur**

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te fletorja e punës e klasës së parë.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 8

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Arte	<b>Lënda:</b> Edukatë figurative	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> I	<b>Klasa:</b> I
<b>Gjuha dhe komunikimi artistik</b> <b>Tema:</b> Format dhe modelimi		<b>Rezultati i të nxënësve të temës (nga plani dymujor):</b> - Dallon dhe demonstron dyshembuj për përbërjen dhe strukturën e formave. - Identifikon ngjyrat bazë.	
<b>Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b> II.1. Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta. II.3. Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materialet e ndryshme ricikluese duke u mbështetur në imagjinatën e vet. V.5. Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë/shkollë apo jashtë saj.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> 2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit/et njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatese. 1.1. Vizaton, ngjyros, e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në temë të caktuar. 4.2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Forma gjeometrike		<b>Fjalët kyçe:</b> format gjeometrike (rrethi, katrori, trekëndëshi, drejtkëndëshi), ngjyrat: e verdhë, e kuqe, e kaltër.	
<b>Rezultati/et e të nxënësve për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Dallon format gjeometrike bazë (rrethin, katrorin, trekëndëshin) dhe karakteristikat e tyre. - Vizaton me model dhe pret disa nga format gjeometrike në letra me ngjyra (të verdhë, të kuqe dhe e kaltër). - Kombinon format gjeometrike (sipas formave dhe ngjyrave) në një krijim dekorativ. - Çmon dhe vlerëson krijimin e tij me format gjeometrike dhe të shokëve të klasës. <b>Kriteret e suksesit:</b> - Vizaton format gjeometrike bazë, rrethin, katrorin dhe rrethin mbi letrat me ngjyra. - Pret me gërshërë vizatimet e formave gjeometrike. - Kombinon sipas formave gjeometrike dhe ngjyrave, duke krijuar një dekoracion.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, fletë vizatimi, forma të gatshme gjeometrike matematikore, letra me ngjyra (e verdhë, e kuqe, e kaltër), laps, gërshërë dhe ngjitës.		<b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> <b>Fusha:</b> Shkencat natyrore, Matematika, Gjuha dhe komunikimi.	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtarisë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedimi**

Mësuesi/ja u tregon nxënësve format gjeometrike bazë (rrethin, trekëndëshin, katrorin dhe drejtkëndëshin), dhe i fton nxënësit/et t'i emërtojnë ato.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Punë dyshe, demonstrim**

Mbasi nxënësit/et i kanë emërtuar format gjeometrike, mësuesi/ja i pyet për karakteristikat e tyre, nëpërmjet skemave të thjeshta.

Në këto skema, ata mund të lexojnë qartë brinjët e barabarta të katrorit, rrezet e barabarta të rrethit, tri brinjët e trekëndëshit dhe brinjët paralele të drejtkëndëshit. Pasi nxënësit/et mbarojnë me argumentimet e tyre, mësuesi/ja i përforcon këto karakteristika të figurave gjeometrike. Më pas, mësuesi/ja i orienton nxënësit/et të përdorin mjetet e matematikës për të vizatuar 3 rrahtë me tri ngjyrat bazë, 3 trekëndësha me tri ngjyrat bazë dhe 6 trekëndësha (ose tre) me këto tri ngjyra. Më pas i fton, nëpërmjet demonstrimit të bëjnë kombinime të ndryshme të tyre dhe kur të binden që është kombinimi i duhur t'i ngjisin mbi letër. Punimi realizohet në punë dyshe, ku nxënësit/et ndihmojnë dhe mësojnë nga aftësitë e njëri-tjetrit.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi**

Kur puna ka mbaruar, nxënësit/et shpjegojnë mënyrën e realizimit të punimit dhe mënyrën e kombinimit të figurave dhe ngjyrave. Ata çmojnë dhe vlerësojnë edhe punën e shokëve të klasës.

**Vlerësimi i nxënësve****Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:**

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

**Detyrat dhe puna e pavarur**

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te fletorja e punës e klasës së parë.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 9

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Arte	<b>Lënda:</b> Edukatë figurative	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> I	<b>Klasa:</b> I
<b>Krijimtaria dhe performanca artistike</b> <b>Tema:</b> Forma dhe modelimi		<b>Rezultati i të nxënësve të temës (nga plani dymujor):</b> - Modelon së paku 2 figura të thjeshta. - Dallon dhe demonstroi dy shembuj për përbërjen dhe strukturën e formave. Kupton dhe tregon vendosjen e formave në hapësirë.	
<b>Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës (të synuara):</b> II.1. Gjen veçoritë (në njërën nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta. III.7. Identifikon njohuritë që ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive. III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/ aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> 2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit/et njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse. 1.1 Vizaton, ngjyros, e modelon me laps, me ngjyra, me plastelinë, me letër e materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose me temë të caktuar. 4. 2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Zbulojmë forma të ndryshme		<b>Fjalët kyçe:</b> imazhe dhe objekte me forma të rregullta gjeometrike, objekte me forma të çrregullta.	
<b>Rezultati/et e të nxënësve për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Dallon objekte me forma gjeometrike dhe objekte me forma të çrregullta nga mjedisi që e rrethon. - Vizaton objekte të ngjashme me forma gjeometrike dhe me forma të çrregullta. - Emërton objektet dhe vlerëson punën e tij në kërkim të formave dhe të shokëve të klasës. <b>Kriteret e suksesit:</b> - Vizaton objekte të krijuara nga dora e njeriut dhe nga natyra, që janë të ngjashme me figurat gjeometrike. - Vizaton objekte të ndryshme, që kanë forma të çrregullta.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, fletë e modeluar në libër, lapsa me ngjyra, imazhe të objekteve të ndryshme.		<b>Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> <b>Fusha:</b> Shkencat natyrore, Matematika, Gjuha dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Puna dhe jeta.	
<b>Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtarisë e punës me nxënës gjatë orës mësimore</b>			

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedimi**

Mësuesi/ja u tregon nxënësve imazhe të objekteve ose objekte të ngjashme me format gjeometrike bazë dhe i fton nxënësit/et t'i emërtojnë ato. Më pas, mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të krahasojnë formën e objekteve me figurat gjeometrike bazë. Nxënësit/et krahasojnë orën me rrethin, derën me drejtkëndëshin, fletoren me katrorin, flamurin e festave me trekëndëshin etj.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim i lirë, punë individuale**

Më pas, mësuesi/ja tregon imazhe të objekteve ose objekte që kanë forma të çrregullta dhe pyet nxënësit/et: Po këto objekte, a kanë forma të rregullta gjeometrike? Pasi merr përgjigjen nga nxënësit/et, mësuesi/ja shpjegon që disa objekte në natyrë kanë forma të ngjashme me format gjeometrike e disa të tjerë kanë forma të çrregullta, si këto objekte që shohim. Mësuesi/ja shpërndan fotokopjen e ushtrimit të modeluar në libër dhe udhëzon nxënësit/et për plotësimin e saj. Mësuesi/ja thekson se ky është një kërkim mbi formën e cila bazohet në kërkimet personale të gjithsecilit. Nxënësit/et kërkojnë dhe vizatojnë objekte të ngjashme me format gjeometrike të kërkuara aty. Ata vizatojnë gjithashtu edhe objekte që kanë forma të çrregullta e më pas i emërtojnë ato.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi**

Kur puna ka mbaruar, nxënësit/et shpjegojnë kërkimin e tyre mbi formën. Tregojnë objektet që kanë vizatuar, ngjashmërinë me formën gjeometrike përkatëse, objektet me forma të çrregullta dhe vendin ku ato ndodhen. Ata çmojnë dhe vlerësojnë edhe punën e shokëve të klasës.

**Vlerësimi i nxënësve****Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:**

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

**Detyrat dhe puna e pavarur**

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te fletorja e punës e klasës së parë.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 10

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Arte	<b>Lënda:</b> Edukatë figurative	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> I	<b>Klasa:</b> I
<b>Gjuha dhe komunikimi artistik Tema:</b> Llojet e ngjyrave dhe teknikat		<b>Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):</b> - Identifikon ngjyrat bazë. - Njeh mënyrën e përdorimit të ngjyrave.	
<b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b>  II.1. Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta. III.7. Identifikon njohuritë që ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive. III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> 2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit/et njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse. 1.1 Vizaton, ngjyros e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose me temë të caktuar. 4.2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Ngjyrat primare		<b>Fjalët kyçe:</b> ngjyrat primare: e verdha, e kuqja dhe e kaltra.	
<b>Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Dallon ngjyrat primare në mjedisin që e rrethon. - Përdor kombinimin e ngjyrave primare dhe të formave të thjeshta në krijim. - Vlerëson mënyrën e kombinimit të ngjyrave primare dhe të formave në krijimin e tij/saj dhe të shokëve të klasës. <b>Kriteret e suksesit:</b> - Përdor ngjyrat primare dhe format e thjeshta në krijim. - Kombinon ngjyrat primare dhe format e thjeshta gjeometrike në dekoracion.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, imazhe që ilustrojnë ngjyrat primare, fletë e bardhë, fleta me ngjyrat bazë, laps, gërshtë, ngjitës.		<b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> Fusha: Shkencat natyrore, Matematika, Gjuha dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi.	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			
<b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:</b> Kujtesa pamore, bashkëbisedim Mësuesi/ja u tregon nxënësve imazhe që ilustrojnë ngjyrat bazë. Për të verdhën: limonin, bananen, lule të verdhë etj.; për të kuqen: trëndafilin, mollën, flamurin etj.; për të kaltrën: qiellin, detin etj. Nxënësit/et ftohen të identifikojnë ngjyrat dhe të japin edhe shembuj të tjerë të objekteve apo fenomeneve me që kanë ngjyrat bazë. <b>Ndërtimi i njohurive të reja:</b> Punë dyshe, demonstrim Mësuesi/ja shpjegon se ngjyrat bazë ose primare quhen kështu pasi prej tyre krijohen ngjyrat e tjera.			



Mësuesi/ja i orienton nxënësit/et të realizojnë një krijim dekorativ duke përdorur kombinimin e ngjyrave primare dhe të formës së katrorit. Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të presin nga tre katrorë të mëdhenj dhe nga tre katrorë të vegjël për çdo ngjyrë, si dhe demonstroi mënyrën e realizimit të tyre.

Nxënësit/et punojnë dyshe dhe ndajnë punën për realizimin e katrorëve. Më pas, mësuesi/ja i orienton të kombinojnë katrorët e mëdhenj me të vegjël. Mësuesi/ja iu tërheq vëmendjen që ata të kenë vëmendje të kombinimet e ngjyrave. Kur nxënësit binden për kombinimin e duhur, i ngjisin katrorët mbi letrën e bardhë.

#### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi**

Kur puna ka mbaruar, nxënësit shpjegojnë se ata kanë përdorur ngjyrat kryesore dhe kombinimin e tyre në krijimin dekorativ. Ata çmojnë dhe vlerësojnë edhe punën e shokëve të klasës.

#### **Vlerësimi i nxënësve**

##### **Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:**

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

#### **Detyrat dhe puna e pavarur**

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te fletorja e punës e klasës së parë.

#### **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 11

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Arte	<b>Lënda:</b> Edukatë figurative	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> I	<b>Klasa:</b> I
<b>Gjuha dhe komunikimi artistik Tema:</b> Llojet e ngjyrave dhe teknikat		<b>Rezultati i të nxënës të temës (nga plani dymujor):</b> - Identifikon ngjyrat bazë. - Njeh mënyrën e përdorimit të ngjyrave. - Përvetëson njohuritë mbi ngjyrën dhe ngjyros së paku 3 punime me ngjyra lapsi dhe flamastera.	
<b>Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b>  III.7. Identifikon njohuritë që ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive. IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/ aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj). IV.5. Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b>  2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit/et njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse. 1.1. Vizaton, ngjyrosë, e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose me temë të caktuar. 4.2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Ngjyrat dhe emocionet		<b>Fjalët kyçe:</b> ngjyrat primare dhe emocionet: e verdha (gëzim, ngrohtësi), e kuqja (zemërim, nxehtësi) dhe e kaltra (mërzi dhe ftohtësi).	
<b>Rezultati/et e të nxënës për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Zbulon që ngjyrat krijojnë emocione të veçanta. - Vizaton dhe ngjyros objekte që kanë si karakteristikë ngjyrat primare. - Analizon karakteristikat emocionale të ngjyrave. <b>Kriteret e suksesit:</b> - Vizaton objekte të ndryshme që kanë karakteristikë ngjyrat primare. - Përdor karakteristikat emocionale të ngjyrave në krijim.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, imazhe të thjeshta skematike që ilustrojnë anën emocionale të ngjyrave, fletë e bardhë, lapsa me ngjyra ose pastela.		<b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> Shkencat natyrore, Shkencat shoqërore, Gjuha dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Puna dhe jeta.	
<b>Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore</b>			

### **Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim**

Mësuesi/ja u drejton pyetjen nxënësve: nëse ngjyra e verdhë na kujton diellin dhe rrezet e tij, me çfarë emocioni do ta lidhnim këtë ngjyrë? (Me pyetje të formuluar në këtë mënyrë mund të marrim përgjigjen që duam nga nxënësit/et.) Mësuesi/ja nxjerr një imazh skematik (imitim i fytyrës) që tregon shprehjen e ngrohtësisë dhe pyet: A i përshtatet kjo shprehje ngjyrës së ngrohtë?

Në këtë mënyrë, mësuesi/ja vepron edhe me ngjyrën e kuqe, të lidhur me ndjenjën e nxehtësisë, apo të kaltrën të lidhur me ndjenjën e të ftohtit.

### **Ndërtimi i njohurive të reja: Punë individuale dhe në grup**

Më pas, mësuesi/ja vendos pranë secilës fytyrë të skematizuar nga një të dytë për çdo ngjyrë. Në to përshkruhet nga një tjetër emocion i ngjyrës. Gëzim, për të verdhën, mërzi, për të kaltrën dhe zemërim për të kuqen. Mësuesi/ja shpjegon se këto gjendje emocionale kanë lidhje me njëra-tjetrën brenda çdo ngjyre.

Mësuesi/ja i orienton nxënësit/et të vizatojnë dhe të ngjyrosin tri objekte ose piktura dhe të përdorin nga një ngjyrë për secilën. Pasi nxënësit/et realizojnë punimet e tyre individuale i grumbullojnë punimet me të njëjtën ngjyrë së bashku.

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi**

Kur puna ka mbaruar, nxënësit/et diskutojnë për emocionet që të krijon çdo ngjyrë. Ata vlerësojnë dhe diskutojnë së bashku duke ndarë mendimet dhe duke respektuar njëri-tjetrin.

### **Vlerësimi i nxënësve**

#### **Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:**

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

### **Detyrat dhe puna e pavarur**

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te fletorja e punës e klasës së parë.

### **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 12

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Arte	<b>Lënda:</b> Edukatë figurative	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> I	<b>Klasa:</b> I
<b>Krijimtaria dhe performanca artistike</b> <b>Tema:</b> Ngjyra		<b>Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):</b> - Identifikon ngjyrat bazë. - Njeh mënyrën e përdorimit të ngjyrave. - Kupton teknikat dhe ngjyros së paku 3 punime me ngjyra të ujit.	
<b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b> III.7. Identifikon njohuritë që ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive. IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/ aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj). III.4 I jep zgjidhje në mënyrë të pavarur problemit, detyrës së dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> 2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit/et njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse. 1.1. Vizaton, ngjyros e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e me materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose me temë të caktuar. 4. 2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Pikturë me tri ngjyra		<b>Fjalët kyçe:</b> ngjyrat primare, ngjyra uji.	
<b>Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Dallon përdorimin e ngjyrave primare në disa vepra arti ku ato janë mbizotëruese. - Përzgjedh një temë sipas dëshirës për krijimin e vet. - Përdor ngjyrat primare dhe ngjyrat e ujit në krijim. - Shpjegon temën që zgjodhi dhe mënyrën si e realizoi. <b>Kriteret e suksesit:</b> - Krijon duke zgjedhur një temë sipas dëshirës. - Përdor ngjyrat primare dhe ngjyrat e ujit në krijim.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, imazhe të veprave të artit të realizuara me tri ngjyrat primare, ngjyra uji (tempera ose akuarele).		<b>Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> Shkencat natyrore, Shoqëria dhe mjedisi, Gjuha dhe komunikimi.	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			
<b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:</b> Kujtesa pamore (bashkëbisedim) Mësuesi/ja shfaq disa vepra (tri ose katër) arti, në të cilat janë përdorur tri ngjyrat primare (shembuj të tillë mund të gjejmë nga artistë figurativë të artit modern siç mund të jenë: Roi Lihtenshtejn, Henri Matis apo Pit Mondrian). Mësuesi/ja i orienton nxënësit/et të vëzhgojnë pikturat dhe të gjejnë ngjyrat që janë përdorur në to. Nxënësit/et do të identifikojnë tri ngjyrat bazë (të kaltrën, të kuqen dhe të verdhën), por gjithashtu mund të vërejnë edhe të bardhën dhe të zezën. Në këtë rast, mësuesi/ja i orienton ata të përqendrohen te tri ngjyrat.			

**Ndërtimi i njohurive të reja: Punë individuale, hulumtim i orientuar**

Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të realizojnë një punim ku të përdorin vetëm tri ngjyrat bazë dhe ta realizojnë atë, nëpërmjet ngjyrave të ujit.

Për të ndihmuar kreativitetin e nxënësve, mësuesi/ja i nxit ata nëpërmjet disa temave të gatshme (si alternativa). Çdo nxënës zgjedh temën që i pëlqen më shumë dhe e realizon atë me ngjyra uji.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi**

Kur puna ka mbaruar, nxënësit/et diskutojnë për temën që kanë zgjedhur, si i kanë shpërndarë ngjyrat (p.sh. topi i kuq, rëra e verdhë dhe deti i kaltër). Ata vlerësojnë dhe diskutojnë së bashku duke ndarë mendimet dhe duke respektuar njëri-tjetrin.

**Vlerësimi i nxënësve**

**Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:**

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

**Detyrat dhe puna e pavarur**

Detyra zhvillohet në fletë ose në fletoren e vizatimit.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 13

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Arte	<b>Lënda:</b> Edukatë figurative	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> I	<b>Klasa:</b> I
<b>Gjuha dhe komunikimi artistik</b> <b>Tema:</b> Llojet e ngjyrave dhe teknikat		<b>Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):</b> - Identifikon ngjyrat. - Njeh mënyrën e përdorimit të ngjyrave dhe dallon teknikën e akuaelit (me ujë). - Njeh mënyrën e përdorimit të ngjyrave.	
<b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b> III.7 Identifikon njohuritë që ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive. IV.2 Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/ aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj). III. 2 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në një material tjetër për të realizuar një veprim/ aktivitet/ detyrë që kërkohet prej tij/saj.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> 2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit/et njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse; 1.1. Vizaton, ngjyros, e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në temë të caktuar; 4. 2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Ngjyrat sekondare		<b>Fjalët kyçe:</b> ngjyrat primare, ngjyrat sekondare (e gjelbër, portokalli, vjollcë), ngjyra uji.	
<b>Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Zbulon ngjyrat sekondare nëpërmjet përzierjes së ngjyrave primare. - Plotëson rrethin e ngjyrave duke përzier ngjyrat primare. - Përdor ngjyrat e ujit për të plotësuar rrethin e ngjyrave. - Shpjegon mënyrën e plotësimit të rrethit të ngjyrave. <b>Kriteret e suksesit:</b> - Përzien ngjyrat primare për të krijuar ngjyrat sekondare. - Plotëson rrethin e ngjyrave me ngjyrat primare dhe sekondare. - Përdor ngjyrat e ujit për të realizuar përzierjen e ngjyrave.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, ngjyra uji (tempera ose akuaele), skema e ngjyrave të dyta, skema e rrethit të ngjyrave për t'u plotësuar.		<b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> Shkencat natyrore, Gjuha dhe komunikimi.	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Eksperimenti, bashkëbisedim**

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit/et të bëjnë gati ngjyrat e ujit, penelin, gotën e ujit dhe letrën. Ai/ajo i pyet nxënësit/et të emërtojnë ngjyrat që kanë përpara (në kutinë e ngjyrave të ujit ndodhen edhe ngjyrrat e tjera, përveç ngjyrave primare). Më pas, mësuesi/ja i pyet nxënësit/et: Si krijohen ngjyrat e tjera? Le ta zbulojmë. Mësuesi/ja i orienton të përziejnë të verdhën me të kaltrën, dhe ata zbulojnë vetë ngjyrën e gjelbër. Më pas, ata përziejnë të verdhën me të kuqen dhe zbulojnë ngjyrën portokalli. Në fund, përziejnë ngjyrën e kaltër me të kuqe dhe zbulojnë ngjyrën vjollcë. Pra, çfarë ndodh kur përziejnë ngjyrat primare?

**Ndërtimi i njohurive të reja: Punë individuale, hulumtim i orientuar**

Mësuesi/ja shpjegon që ngjyrat primare mund të përzihen për të krijuar ngjyrat sekondare. Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve fletat me skemën e paplotësuar të rrethit të ngjyrave dhe u shpjegon si duhet ta plotësojnë. Nxënësit/et ndjekin udhëzimet nëpërmjet eksperimentit me borat. Në fillim plotësojnë vendet e ngjyrave primare dhe pastaj, ndërmjet tyre krijojnë ngjyrat sekondare.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Kllasteri (diskutimi)**

Pasi plotësojnë rrethin me ngjyrat primare dhe ato sekondare, nxënësit/et plotësojnë emërtimin me shkrim të ngjyrave. Ata i tregojnë rrethin e ngjyrave njëri tjetrit dhe lexojnë emrat e ngjyrave të shkruara duke i klasifikuar në tabelën e fletës (tabela është një paraqitje e thjeshtë e teknikës së kllasterit).

**Vlerësimi i nxënësve****Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:**

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

**Detyrat dhe puna e pavarur**

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te fletorja e punës e klasës së parë.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 14

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Arte	<b>Lënda:</b> Edukatë figurative	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> I	<b>Klasa:</b> I
<b>Krijimtaria dhe performanca artistike</b> <b>Tema:</b> Ngjyra		<b>Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):</b> Njeh dhe përdor mjetet e ngjyrosjes (ngjyra uji, peneli).	
<b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b> III.1. Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjët, ngjyrat, numërorin etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë. IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/ aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj). III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> 2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit/et njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse. 1.1. Vizaton, ngjyros e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e me materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose me temë të caktuar.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Si të përdorim penelin		<b>Fjalët kyçe:</b> peneli, ngjyra uji, mjetet e punës, mirëmbajtja.	
<b>Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Njeh rregullat e mirëmbajtjes së penelit. - Eksperimenton me penelin dhe ngjyrat e ujit duke ndjekur udhëzimet e duhura. - Shpjegon mënyrën e përdorimit të penelit dhe të ngjyrave të ujit. <b>Kriteret e suksesit:</b> - Përdor penelin dhe ngjyrat e ujit për të krijuar. - Eksperimenton me penelin dhe ngjyrat në krijimin e tij/saj.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, ngjyra uji, penela, gotë me ujë, letër e bardhë.		<b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> <b>Fusha:</b> Shoqëria dhe mjedisi, Gjuha dhe komunikimi, Puna dhe jeta.	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			
<b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Brainstorming (bashkëbisedim)</b> Mësuesi/ja tregon ngjyrat e ujit dhe i pyet nxënësit/et: cilat janë mjetet që përdorim kur punojmë me ngjyra uji? Nxënësit/et rendisin: penelin, gotën e ujit, letrën. Mësuesi/ja i nxit akoma: Për çfarë i përdorim ngjyrat e ujit me mjetet e duhura? Nxënësit/et rendisin: pikturat, ngjyrosjen etj. A dini ju t'i përdorni si duhet? Po penelin? A janë të shumëllojshëm penelat?			



**Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, demonstrim, eksperimenti**

Mësuesi/ja shpjegon se penelat kanë madhësi të ndryshme dhe ne i përdorim për të pikturuar (mësuesi/ja tregon penela me madhësi të ndryshme). Por peneli ka nevojë për kujdes të veçantë, në mënyrë që të na ndihmojë për të bërë piktura të bukura. Nëpërmjet demonstrimit, mësuesi/ja tregon disa rregulla të përdorimit të penelit. Më pas, mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et të ndjekin demonstrimin e tij/saj në përdorimin e penelave dhe të ngjyrate të ujit. Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të eksperimentojnë me mjetet e tyre me ngjyrat e ujit dhe me penelin.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Kllasteri (diskutimi)**

Në fund të orës së mësimit, nxënësit/et shpjegojnë rregullat e përdorimit të penelit dhe shpjegojnë eksperimentin e tyre nëpërmjet hapave që ndoqën.

**Vlerësimi i nxënësve**

**Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:**

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

**Detyrat dhe puna e pavarur**

Detyra zhvillohet në fletë ose në fletoren e vizatimit.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 15

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Arte	<b>Lënda:</b> Edukatë figurative	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> I	<b>Klasa:</b> I
<b>Krijimtaria dhe performanca artistike</b> <b>Tema:</b> Ngjyra		<b>Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):</b> - Njeh dhe përdor mjetet e ngjyrosjes (ngjyra uji, peneli). - Kupton teknikat dhe të ngjyros së paku 3 punime me ngjyra të ujit.	
<b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b> III.1. Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjët, ngjyrat, numërorin etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë. IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/ aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj). III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/ aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> 2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit/et njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse. 1.1. Vizaton, ngjyros e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e me materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose me temë të caktuar. 4.1. Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike, me disa fjali të thjeshta, gjatë bisedës dhe vrojtimit, me lëvizje, mimikë, me mjete shprehëse të tjera etj.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Pikturë me akualet		<b>Fjalët kyçe:</b> peneli, akualet (ngjyra uji).	
<b>Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Përzgjedh temën për krijimin e tij/saj. - Përdor ngjyrat e ujit në krijim në përshtatje me temë. - Shpjegon temën që ka përzgjedhur dhe ngjyrat që ka përdorur. <b>Kriteret e suksesit:</b> - Përdor ngjyrat e ujit në krijim. - Përzgjedh ngjyrat sipas temës që ka zgjedhur.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, ngjyra uji, penela, gotë me ujë, letër e bardhë, imazhe të veprave të artistëve të ndryshëm me akualet.		<b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> <b>Fusha:</b> Shoqëria dhe mjedisi, Artet (muzika), Gjuha dhe komunikimi.	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			
<b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore (bashkëbisedim)</b> Mësuesi/ja tregon veprat e katër artistëve të realizuara në teknikën e akualetit (mësuesi/ja mund të përdorë imazhet e librit ose të zgjedhë vetë të tjera). I fton nxënësit/et të vëzhgojnë pikturat me kujdes dhe se çfarë paraqesin ato. Mësuesi/ja shpjegon që titujt e pikturave ndodhen në libër dhe ata duhet të gjejnë se cilës pikturë i përkasin. Mësuesi/ja i orienton që të lidhin titullin me atë që paraqitet në pikturë.			

**Ndërtimi i njohurive të reja: Punë individuale**

Më pas, mësuesi/ja i fton nxënësit/et të krijojnë edhe ata një pikturë duke përdorur ngjyrat e ujit. Ai/ ajo i porositi të kujtojnë mënyrën e përdorimit që mësuan një orë më parë. Mësuesi/ja u jep disa tema nxënësve dhe u thotë të zgjedhin një të tyre ose të bëjnë një temë sipas dëshirës.

Ajo i porositi të kujtojnë se si artistët kanë zgjedhur ngjyrat në lidhje me temën që kanë paraqitur. Nxënësit/et përzgjedhin temën dhe realizojnë pikturën e tyre.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur: Diskutimi**

Kur mbaron puna, nxënësit/et u tregojnë punimin shokëve dhe shoqe të klasës dhe shpjegojnë temën dhe ngjyrat që zgjedhën për pikturën e tyre. Ata vlerësojnë edhe punimet e shokëve të klasës.

**Vlerësimi i nxënësve**

**Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:**

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

**Detyrat dhe puna e pavarur**

Detyra zhvillohet në fletë ose në fletoren e vizatimit.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 16

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Arte	<b>Lënda:</b> Edukatë figurative	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> I	<b>Klasa:</b> I
<b>Krijimtaria dhe performanca artistike</b> <b>Tema:</b> Ngjyra <sup>1</sup>		<b>Rezultati i të nxënimit të temës (nga plani dymujor):</b> - Njeh dhe përdor mjetet e ngjyrosjes (ngjyra uji, peneli). - Realizon një shtyp të thjeshtë nga gjurmët e ndryshme (shtyp në letër ose material tjetër praktik me anë të ngjyrave). - Bisedon dhe njeh disa shembuj me ngjyra (p.sh. flutura, ylberi, lulet, kafshët etj.).	
<b>Rezultatet e të nxënimit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b> III.1. Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjët, ngjyrat, numërorin etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë. IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/ aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj). III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në një material tjetër për të realizuar një veprim/ aktivitet/ detyrë që kërkohet prej tij/saj.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :</b> 2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit/et njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse. 1.1. Vizaton, ngjyros e modelon me laps, me ngjyra, me plastelinë, me letër e me materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose me temë të caktuar. 4.2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Flutura dhe ngjyrat		<b>Fjalët kyçe:</b> peneli, ngjyra uji	
<b>Rezultati/et e të nxënimit për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Identifikon simetrinë e ngjyrave dhe formave në krahët e fluturës. - Përdor ngjyrat dhe teknikën e shtypit për të realizuar fluturën simetrike si në ngjyrë dhe në formë. - Shpjegon mënyrën e realizimit dhe ngjyrat që zgjodhi në punimin e tij/saj. <b>Kriteret e suksesit:</b> - Realizon simetrinë e ngjyrave dhe formave në krahët e fluturës. - Përdor teknikën e shtypit dhe ngjyrat e ujit për të krijuar fluturën simetrike.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, ngjyra uji (tempera), penela, gotë me ujë, letër e bardhë, letër me ngjyra, gërshërë, ngjitës.		<b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> <b>Fusha:</b> Shkencat natyrore, Matematika, Gjuha dhe komunikimi.	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			

<sup>1</sup> Kjo temë ndërthuret edhe me teknikën e shtypit.

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore (bashkëbisedim)**

Mësuesi/ja paraqet imazhet e disa fluturave dhe i fton nxënësit/et t'i vëzhgojnë dhe i nxit t'u përgjigjen pyetjeve: A janë të barabarta krahët e fluturës?

Po ngjyrat, a janë të njëjtat në të dyja krahët?

**Ndërtimi i njohurive të reja: kujtesa pamore, demonstrim**

Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se krahët e fluturës janë të barabartë. Nëpërmjet ilustrimit të fluturës, mësuesi/ja u tregon nxënësve se ngjyrat e shumëllojshme të saj kanë frymëzuar artistët. Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të realizojnë një flutur me ngjyra dhe me krahë të barabartë nëpërmjet një teknike shtypi interesante (kjo teknikë është monotipi, por ndoshta është ende herët për ta cilësuar me emrin "monotip"). Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të ndjekin demonstrimin e tij/saj dhe ta realizojnë fluturën e tyre me ngjyrat që dëshirojnë.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur: kllasteri, diskutimi**

Kur mbaron puna, nxënësit/et u tregojnë punimin shokëve dhe shoqe të klasës dhe shpjegojnë mënyrën e realizimit, si dhe ngjyrat që zgjodhën për pikturën e tyre. Ata vlerësojnë edhe punimet e shokëve të klasës.

**Vlerësimi i nxënësve**

**Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:**

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

**Detyrat dhe puna e pavarur**

Detyra zhvillohet në fletë ndërsa në fletoren e punës janë disa ushtrime plotësuese për simetrinë.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 17

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Arte	<b>Lënda:</b> Edukatë figurative	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> I	<b>Klasa:</b> I
<b>Krijimtaria dhe performanca artistike</b> <b>Tema:</b> Gjurmët dhe shenjat. (Tekstura <sup>2</sup> )		<b>Rezultati i të nxënitorëve të temës (nga plani dymujor):</b> - Njeh karakteristikat e sipërfaqeve të ndryshme nëpërmjet shtypit të thjeshtë dhe riprodhimit. - Realizon 1 shtyp të thjeshtë nga gjurmët e ndryshme (shtyp në letër ose material tjetër praktik me anë të ngjyrave). - Njeh dhe të përdor mjetet e ngjyrosjes (pastelat).	
<b>Rezultatet e të nxënitorëve për kompetencat kryesore të shkollës (të synuara):</b> IV.5 Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë. IV.2 Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/ aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj). III.2 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/ aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> 2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit/et njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse. 1.1. Vizaton, ngjyros e modelon me laps, me ngjyra, me plastelinë, me letër e materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose me temë të caktuar. 4. 2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Tekstura		<b>Fjalët kyçe:</b> tekstura, gjurmët dhe shenjat	
<b>Rezultati/et e të nxënitorëve për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Identifikon karakteristikat e sipërfaqeve (teksturave) të objekteve të ndryshme. - Zbulon që tekstura e objekteve mund të shihet dhe të preket. - Përdor teknika të thjeshta të shtypit për të eksperimentuar me tekstura të ndryshme. - Shpjegon teksturat që ka përzgjedhur dhe ngjyrat që ka përdorur. <b>Kriteret e suksesit:</b> - Përzgjedhin sipërfaqe me karakteristika të ndryshme për të krijuar teksturën në krijim. - Krijon teksturën e objekteve në krijimin e tij/saj. - Përdor teknika të thjeshta eksperimentale të shtypit.			

<sup>2</sup> Tekstura është një element i rëndësishëm i artit dhe shërben për të njohur sipërfaqet e objekteve të ndryshme. Për të kuptuar këtë njohuri është përdorur një teknikë e thjeshtë e shtypit, që përdoret me lehtësi nga nxënësit e kësaj moshe. Rezultatet e të nxënitorëve të temës mund t'i gjejmë të pasqyruara në temën, gjurmët dhe shenjat. Nëpërmjet teknikës së shtypit për ta bërë të kuptueshme teksturën për nxënësit e kthejmë atë në gjurmë e shenja duke e riprodhuar dhe bërë të dukshme mbi letër.

<p><b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, imazhe që paraqesin objekte me tekstura të ndryshme, objekte të thjeshta me tekstura të ndryshme, pastela, fletë vizatimi, gërshërë, ngjitëse.</p>	<p><b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> <b>Fusha:</b> Shkencat natyrore, Gjuha dhe komunikimi.</p>
<p><b>Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore</b></p>	
<p><b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore (bashkëbisedim)</b> Mësuesi/ja paraqet imazhet e disa objekteve që kanë karakteristika të veçanta dhe shumë të dukshme të teksturës. Mësuesi i nxit nxënësit/et të identifikojnë karakteristikat e sipërfaqeve. Gjithashtu, në libër, nxënësit/et mund të vendosin poshtë çdo imazhi, fjalën që përshkruan më mirë karakteristikën e sipërfaqes së tyre. Gjithashtu nxënësit/et mund të sjellin shembuj të sipërfaqeve të ndryshme, edhe nga mjedisi përreth.</p> <p><b>Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore (demonstrim eksperimenti)</b> Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se: Karakteristikat e sipërfaqes i quajmë teksturë. Më pas, mësuesi/ja i orienton nxënësit të shohin dhe pastaj ta prekin një sipërfaqe. Mësuesi/ja shpjegon se teksturën mund ta kuptojmë nëpërmjet të parit dhe nëpërmjet të prekurit. Për ta kuptuar më mirë teksturën e sipërfaqeve të objekteve, mësuesi/ja i orienton nxënësit të eksperimentojnë duke i kaluar gjurmët dhe shenjat e teksturës sipër letrës së vizatimit. Mësuesi/ja i orienton nxënësit të ndjekin demonstrimin dhe më pas të realizojnë eksperimentin e tyre me tekstura të ndryshme. Për këtë, nxënësve u nevojiten sipërfaqe me tekstura të ndryshme dhe pastela. Nxënësit mund të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për të shkëmbyer teksturat. Nxënësit e ndajnë fletën në 6 katrorë dhe pastaj i presin. Në çdo katror kalojnë nga një teksturë, e më pas i ngjisin përsëri së bashku.</p> <p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Kllasteri (diskutim)</b> Kur mbaron puna, nxënësit u tregojnë eksperimentin shokëve dhe shoqe të klasës, si dhe shpjegojnë teksturën që zgjodhën; ngjyrat dhe mënyrën e realizimit. Ata vlerësojnë edhe punimet e shokëve të klasës.</p>	
<p><b>Vlerësimi i nxënësve</b></p>	
<p><b>Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;</li> <li>- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.</li> </ul>	
<p><b>Detyrat dhe puna e pavarur</b></p>	
<p>Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te fletorja e punës e klasës së klasës së parë.</p>	
<p><b>Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore</b></p>	

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 18

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Arte	<b>Lënda:</b> Edukatë figurative	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> I	<b>Klasa:</b> I
<b>Krijimtaria dhe performanca artistike</b> <b>Tema:</b> Gjurmët dhe shenjat		<b>Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):</b> - Realizon një shtyp të thjeshtë nga gjurmët e ndryshme (shtyp në letër ose material tjetër praktik me anë të ngjyrave). - Njeh dhe përdor mjetet e ngjyrosjes (pastelat).	
<b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b> IV.5. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë. IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj). III.4.1 jep zgjidhje në mënyrë të pavarur problemit, detyrës së dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> 2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit/et njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse. 1.1. Vizaton, ngjyros e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e me materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose me temë të caktuar. 4.2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Krijimi im me tekstura		<b>Fjalët kyçe:</b> tekstura, gjurmët dhe shenjat	
<b>Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Vizaton një objekt sipas dëshirës dhe e ndan në disa hapësira. - Përdor teknikën e thjeshtë të shtypit për të realizuar shumëllojshmëri teksturash në krijim. - Shpjegon temën që ka përzgjedhur, ngjyrat dhe teksturën që ka përdorur. <b>Kriteret e suksesit:</b> - Krijon tekstura të shumëllojshme në krijim. - Përdor teknikën e thjeshtë të shtypit për të imituar teksturat e ndryshme.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, objekte të thjeshta me tekstura të ndryshme, pastela, fletë vizatimi, lapsa.		<b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> <b>Fusha:</b> Shkencat natyrore, Gjuha dhe komunikimi.	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			



**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Bashkëbisedim**

Mësuesi/ja i pyet nxënësit/et se në sa mënyra e kuptojmë teksturën e sipërfaqeve të ndryshme? A shfaqen të shumëllojshme teksturat e objekteve në natyrë? A mund të jepni shembuj të teksturave të veçanta? Nëpërmjet këtyre pyetjeve, mësuesi/ja bën një përsëritje të njohurive duke sjellë në vëmendje teksturat e ndryshme. Më pas, mësuesi/ja pyet: A mund të përdorni edhe ju tekstura të ndryshme në krijimin tuaj?

**Ndërtimi i njohurive të reja: Demonstrim, hulumtim i lirë**

Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se për të realizuar një krijim duke përdorur tekstura të ndryshme nevojiten objekte ose mjete me tekstura të ndryshme

(nxënësit/et janë porositur një orë më parë që t'i sjellin me vete, e po ashtu mësuesi/ja ka mbledhur disa prej tyre). Mësuesi/ja i orienton nxënësit/et të zgjedhin një objekt ose një peizazh dhe të ndajnë hapësirat. Shembujt në libër tregojnë rrugën që nxënësit/et duhet të ndjekin. P.sh., në rastin e kungullit, ai ndahet në disa pjesë ku çdo pjesë realizohet me një teksturë të caktuar. Në rastin e peizazhit, objektet që janë aty realizohen me tekstura të ndryshme. Ngjyrat dhe llojet e teksturave për çdo hapësirë të ndarë, nxënësit/et i zgjedhin vetë.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi**

Kur mbaron puna, nxënësit/et u tregojnë punimin shokëve/shoqeve të klasës dhe shpjegojnë teksturën që zgjedhën, ngjyrat dhe mënyrën e realizimit. Ata vlerësojnë edhe punimet e shokëve të klasës.

**Vlerësimi i nxënësve**

**Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:**

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

**Detyrat dhe puna e pavarur**

Detyra zhvillohet në fletë ose në fletoren e vizatimit.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 19

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Arte	<b>Lënda:</b> Edukatë figurative	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> I	<b>Klasa:</b> I
<b>Krijimtaria dhe performanca artistike</b> <b>Tema:</b> Forma dhe modelimi		<b>Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):</b> Përdor materiale të ndryshme (të lehta) për krijime modelimi (3 dimensionale).	
<b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b> IV.5. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë. IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/ aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj). III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/ aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> 1.1. Vizaton, ngjyros e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e me materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose me temë të caktuar. 2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit/et njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse. 4.2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Tekstura reale		<b>Fjalët kyçe:</b> tekstura, gjurmët dhe shenjat	
<b>Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Kupton që tekstura reale është tredimensionale. - Realizon një teksturë reale nëpërmjet modelimit të letrës. - Shpjegon mënyrën e realizimit të teksturës reale. <b>Kriteret e suksesit:</b> - Realizon teksturë reale me relief në letër. - Modelon letrën nëpërmjet prerjes dhe palosjes për të krijuar teksturën.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, letër, laps, vizore, gërshërë.		<b>Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> <b>Fusha:</b> Shkencat natyrore, Matematika, Gjuha dhe komunikimi	
<b>Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimitaritet e punës me nxënës gjatë orës mësimore</b>			

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Bashkëbisedim**

Mësuesi/ja i pyet nxënësit/et se në sa mënyra e kuptojmë teksturën e sipërfaqeve të ndryshme? A shfaqen të shumëllojshme teksturat e objekteve në natyrë? A mund të jepni shembuj të teksturave të veçanta? Nëpërmjet këtyre pyetjeve, mësuesi/ja bën një përsëritje të njohurive duke sjellë në vëmendje teksturat e ndryshme (në këtë njësi situata e të nxënit është e njëjtë me njësinë mësimore të mësipërme pasi bëhet fjalë për konceptin e teksturës).

**Ndërtimi i njohurive të reja: Demonstrim, hulumtim i orientuar**

Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se tekstura e objekteve është reale dhe se ajo ekziston në formën tredimensionale. Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të krijojnë një teksturë reale. Mësuesi/ja demonstroi mënyrën e realizimit të teksturës reale nëpërmjet modelimit të letrës. Ai/ajo shpjegon hapat duke i demonstruar siç paraqiten në libër dhe nxënësit/et e ndjekin.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Harta e të pyeturit, diskutimi**

Kur mbaron puna mësuesi/ja i orienton të prekin me dorë detyrën e realizuar. Pastaj i pyet: A është kjo një teksturë reale? Ku ndryshon me teksturën që realizuam një orë më parë? Pra, teksturën reale e kuptojmë nëpërmjet të prekurit ndërsa teksturën që realizuam një orë më parë e kuptojmë nëpërmjet të të parit. Nxënësit/et u tregojnë punimin shokëve dhe shoqe të klasës dhe shpjegojnë mënyrën e realizimit. Ata vlerësojnë edhe punimet e shokëve të klasës.

**Vlerësimi i nxënësve**

**Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:**

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

**Detyrat dhe puna e pavarur**

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te fletorja e punës e klasës së klasës së parë.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 20

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Arte	<b>Lënda:</b> Edukatë figurative	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> I	<b>Klasa:</b> I
<b>Relacioni art-shoqëri Tema:</b> Projekte dhe shembuj		<b>Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):</b> Njeh disa nga objektet arkitekturale, qilimat, ornamentet, vazot etj.	
<b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b> IV.5. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë. III.7. Identifikon njohuritë që ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive. III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/ aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> 3.1. Vëren dhe identifikon lloje të ndryshme të arteve. 1.1. Vizaton, ngjyros e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në temë të caktuar. 4.2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Endja e qilimit		<b>Fjalët kyçe:</b> qilimi, endja, motivi, përsëritja	
<b>Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Zbulon motivin, përsëritjen e tij dhe teknikën e endjes në qilimat popullore. - Realizon një qilim nëpërmjet endjes së letrës. - Shpjegon mënyrën e realizimit të qilimit nëpërmjet teknikës së endjes. <b>Kriteret e suksesit:</b> - Përgatit letrat me ngjyra për endjen. - Realizon endjen me letra të prera drejt. - Realizon endjen me shirita të prerë zigzak ose të harkuar.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, fleta me ngjyra, laps, vizore, gërshërë.		<b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> <b>Fusha:</b> Shoqëria she mjedisi, Gjuha dhe komunikimi, Puna dhe jeta.	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			
<b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim</b> Mësuesi/ja shfaq imazhin e disa qilimave popullore (ose i referohet qilimit të Drenicës të pasqyruar në tekst) dhe i pyet nxënësit/et: Çfarë figurash shihni në këta qilima? A përsëriten këto figura? Po ju në shtëpi a keni qilima të tillë? Çfarë ngjyrash kanë qilimat që keni parë? A ka ndonjëri ndonjë gjyshe që end qilimat? <b>Ndërtimi i njohurive të reja: Demonstrim, hulumtim i lirë</b> Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se figura ose figurat që përsëriten në qilim quhet motiv ose motive. Motivet mund të jenë të ndryshme në qilima të ndryshëm. Motivet e qilimit që përsëriten krijojnë teksturën që shihet me sy, ndërsa fijet e endura krijojnë teksturën reale, atë të prekshmen.			

Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të realizojnë një qilim nëpërmjet endjes së letrës. Mësuesi/ja demonstroi hapat e endjes me shirita të drejtë. Më pas, mësuesi/ja shpjegon që endja mund të realizohet me shirita të harkuar ose zigzagë. Nxënësit/et ndjekin orientimin e mësuesit/es dhe zgjedhin një mënyrë për të realizuar qilimin e tyre.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi**

Kur mbaron puna, nxënësit/et u tregojnë punimin shokëve dhe shoqe të klasës dhe shpjegojnë llojin e endjes që zgjedhën, ngjyrat dhe mënyrën e realizimit. Ata vlerësojnë edhe punimet e shokëve të klasës.

**Vlerësimi i nxënësve**

**Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:**

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

**Detyrat dhe puna e pavarur**

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te fletorja e punës e klasës së klasës së parë.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 21

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Arte	<b>Lënda:</b> Edukatë figurative	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> I	<b>Klasa:</b> I
<b>Krijimtaria dhe performanca artistike</b> <b>Tema:</b> Forma dhe modelimi		<b>Rezultati i të nxëniet të temës (nga plani dymujor):</b> - Përdor materiale të ndryshme (të lehta) për krijime modelimi. - Njeh dhe të përdor mjete të modelimit me mjete të lehta aplikuese.	
<b>Rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b> IV.5. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë. III.7. Identifikon njohuritë që ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive. III.4.1 jep zgjidhje problemit, detyrës së dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> 1.1. Vizaton, ngjyros e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e me materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose me temë të caktuar. 4. 2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Kolazhi		<b>Fjalët kyçe:</b> kolazh, materiale me tekstura të ndryshme	
<b>Rezultati/et e të nxëniet për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Zbulon që teknika e kolazhit realizohet me materiale të prera dhe të ngjitura mbi një sipërfaqe. - Realizon një kolazh duke përdorur letër të modeluar në mënyra të ndryshme. - Shpjegon mënyrën e realizimit të kolazhit dhe materialeve që përdori. <b>Kriteret e suksesit:</b> - Përgatit dhe modelon letrat me ngjyra për kolazhin. - Krijon kolazhin duke ngjitur letrat e modeluara.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, fleta me ngjyra, gërshtë, ngjitës.		<b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> Fusha: Shkencat natyrore, Gjuha dhe komunikimi.	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			
<b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:</b> Kujtesa pamore, bashkëbisedim Mësuesi/ja shfaq imazhin e kolazhit të Pikasos "Minotaurin", ose i referohet imazhit në libër (Kjo vepër është zgjedhur pasi materialet e përdorura në të janë lehtësisht të identifikueshme nga nxënësit/et e kësaj moshe). Mësuesi/ja drejton pyetjet: Cilat materiale janë përdorur në këtë vepër? A paraqesin tekstura të ndryshme këto materiale?			

**Ndërtimi i njohurive të reja: Demonstrim, hulumtim i lirë**

Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se kjo vepër e Pikasos është realizuar me teknikën e kolazhit. Kolazhi realizohet me materiale të ndryshme, të prera dhe të ngjitura mbi një sipërfaqe. Mësuesi/ ja i nxit nxënësit/et të krijojnë një kolazh dhe të krijojnë tekstura të ndryshme nëpërmjet modelimit të letrës. Për modelimin e letrës, nxënësit/et duhet të përdorin mënyra të tilla si: prerja, palosja, rrotullimi, thurja, zhubrosja, ngjitja. Nxënësit/et përdorin letra me ngjyra dhe ata mund të modelojnë letrën duke pasur parasysh një figuracion të caktuar (lule, pemë, bari, gardhi etj.) ose jo.

Më pas, i ngjisin letrat e modeluara për të krijuar kolazhin e tyre sipas një imazhi (peizazh ose objekte të caktuara) të caktuar.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi**

Kur mbaron puna, nxënësit/et u tregojnë punimin shokëve/shoqeve të klasës dhe shpjegojnë se si i modeluan letrat për të krijuar kolazhin e tyre dhe se çfarë kanë paraqitur ata në kolazh. Ata vlerësojnë edhe punimet e shokëve të klasës.

**Vlerësimi i nxënësve**

**Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:**

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

**Detyrat dhe puna e pavarur**

Detyra zhvillohet në fletë ose në fletoren e vizatimit.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 22

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Arte	<b>Lënda:</b> Edukatë figurative	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> I	<b>Klasa:</b> I
<b>Krijimtaria dhe performanca artistike</b> <b>Tema:</b> Gjurmët dhe shenjat		<b>Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):</b> - Kupton artin e shtypit (grafik) të thjeshtë dhe riprodhimin, p.sh. vula, shtypi me patate, libri etj. - Njeh dhe përdor mjete të shtypit dhe dizenjimit (lapsa, flamastera, ngjyra, penel, patate, letër, shtresë plastike, trekëndësh, gomë etj.).	
<b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b> IV.5. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë. III.7. Identifikon njohuritë që ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive. III.4. I jep zgjidhje në mënyrë të pavarur problemit, detyrës së dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> 1.1. Vizaton, ngjyros e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e me materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose me temë të caktuar. 4.2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Shtypi me materiale të ndryshme		<b>Fjalët kyçe:</b> motivi, tekstile, teknika e shtypit, tekstura.	
<b>Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Zbulon përdorimin e motiveve të shumëllojshme në tekstile të ndryshme. - Përdor teknikën e shtypit me materiale të ndryshme për të krijuar një motiv për tekstile. - Shpjegon mënyrën e realizimit të motivit nëpërmjet teknikës së shtypit. <b>Kriteret e suksesit:</b> - Përgatit katër modelet e shtypit perime dhe fruta. - Përgatit ngjyrat sipas dëshirës. - Krijon katër dekoracione me modelet e zgjedhura nëpërmjet teknikës së shtypit.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, fleta vizatimi, ngjyra uji, materiale për shtyp (patate, mollë, limon, spec etj.).		<b>Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> <b>Fusha:</b> Shkencat natyrore, Puna dhe jeta, Gjuha dhe komunikimi.	
<b>Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore</b>			



**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore (bashkëbisedim)**

Mësuesi/ja shfaq imazhin e disa tekstileve me motive të thjeshta (ose i referohet imazheve në libër) dhe pyet nxënësit/et: Çfarë motivesh paraqiten në këto tekstile? A mund të tregoni motive të tjera që përdoren nëpër tekstile të ndryshme? Për çfarë i përdorim tekstilet? Cili motiv ju pëlqen më shumë? A krijon motivi i këtyre tekstileve teksturën (sipërfaqes) e këtyre tekstileve?

**Ndërtimi i njohurive të reja: Demonstrim, hulumtim i lirë**

Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se tekstura e këtyre tekstileve krijohet nëpërmjet përhapjes së motivit në të gjithë sipërfaqen e tekstileve, nëpërmjet teknikës së shtypit (stampimit). Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të krijojnë dekorime për tekstile në fletoren e tyre.

Mësuesi/ja ka bërë gati mjetet e punës: perimet dhe frutat që do të përdorë për shtyp, ngjyrat e ujit nëpër pjata plastike dhe fletën e vizatimit. Po kështu, edhe nxënësit/et. Në fillim, mësuesi/ja demonstroi dhe i fton nxënësit/et të bëjnë një provë në fletë me të gjitha modelet e shtypit. Më pas, ata zgjedhin nga një model për secilën fletë. Ngjyrën e zgjedhin sipas dëshirës.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi**

Kur mbaron puna, nxënësit/et u tregojnë punimet e tyre të shtypit shokëve dhe shoqe të klasës dhe shpjegojnë dallimin midis modeleve të ndryshme. Tregojnë kush ju pëlqen më shumë dhe pse, kush ishte më i thjeshtë në përdorim dhe ngjyrat që përdorën. Ata vlerësojnë edhe punimet e shokëve të klasës.

**Vlerësimi i nxënësve**

**Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:**

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

**Detyrat dhe puna e pavarur**

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te fletorja e punës e klasës së parë.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 23

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Arte	<b>Lënda:</b> Edukatë figurative	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> I	<b>Klasa:</b> I
<b>Krijimtaria dhe performanca artistike</b> <b>Tema:</b> Gjurmët dhe shenjat		<b>Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):</b> - Kupton artin e shtypit (grafik) të thjeshtë dhe riprodhimin p.sh. vula, shtypi me patate, libri etj. - Njeh dhe përdor mjetet e shtypit dhe dizenjimit (lapsa, flamastera, ngjyra, penel, patate, letër, shtresë plastike, trekëndësh, gomë etj.).	
<b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b> IV.5. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë. III.7. Identifikon njohuritë që ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive. III.4.I jep zgjidhje në mënyrë të pavarur problemit, detyrës së dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> 1.1. Vizaton, ngjyros e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në temë të caktuar. 2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik nxënësit/et njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse. 4.2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të të tjerëve, duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Teknika e shtypit (I)		<b>Fjalët kyçe:</b> teknika e shtypit, ngjyrat e ujit	
<b>Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Përzgjedh frutën e mollës si motiv për punimin e tij/saj. - Përdor teknikën e shtypit me mollë dhe ngjyra uji për të realizuar pemën me mollë ose shportën me mollë. - Shpjegon mënyrën e realizimit të krijimit të tij/saj nëpërmjet teknikës së shtypit. <b>Kriteret e suksesit:</b> - Përgatit modelin/mollën si motiv. - Vizaton trungun e pemës ose realizon shportën me letra me ngjyra, sipas dëshirës. - Realizon kurorën e pemës me mollë nëpërmjet shtypit dhe ngjyrave, ose mbush shportën në të njëjtën mënyrë.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, fleta vizatimi, ngjyra uji, mollë.		<b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> Fusha: Shkencat natyrore, Gjuha dhe komunikimi, Puna dhe jeta	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore (bashkëbisedim)**

Mësuesi/ja pyet nxënësit/et mbi modelet që përdorën dhe hapat që ndoqën për realizimin e punimit një orë më parë (në këtë mënyrë, nxënësit/et kujtojnë teknikën e shtypit të cilën do ta përdorin edhe në këtë orë).

**Ndërtimi i njohurive të reja: Demonstrim, hulumtim i lirë**

Mësuesi/ja tregon frutën e mollës të ndarë në dy pjesë dhe u shpjegon nxënësve se mund ta përdorin si model në punimin e tyre për të krijuar një pemë ose një shportë me mollë.

Mësuesi/ja i orienton të vizatojnë në fillim trungun e pemës ose shportën (në varësi të zgjedhjes), si fillim e më pas me modelin e mollës të bërë me ngjyra sipas dëshirës (duke iu referuar ngjyrave natyrale të saj: e kuqe, e verdhë dhe e gjelbër) mbushin kurorën e pemës ose shportën.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur: Diskutimi**

Kur mbaron puna, nxënësit/et u tregojnë punimet e tyre shokëve dhe shoqe të klasës, si dhe shpjegojnë cilën nga temat zgjodhën dhe si e realizuan. Gjithashtu, ata tregojnë se çfarë ngjyrash ose ngjyre zgjodhën për mollët e tyre. Ata vlerësojnë edhe punimet e shokëve të klasës.

**Vlerësimi i nxënësve**

**Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:**

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

**Detyrat dhe puna e pavarur**

Detyra zhvillohet në fletë ose në fletoren e vizatimit.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 24

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
<b>Krijimtaria dhe performanca artistike</b> <b>Tema:</b> Gjurmët dhe shenjat		<b>Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):</b> - Kupton artin e shtypit (grafik) të thjeshtë dhe riprodhimin p.sh. vula, shtypi me patate, libri etj. - Njeh dhe përdor mjetet e shtypit dhe dizenjimit (lapsa, flamastera, ngjyra, penel, patate, letër, shtresë plastike, trekëndësh, gomë etj.).	
<b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b> VI.2. Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj. V.5. Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë/shkollë apo jashtë saj. IV.6. Diskuton në grup për hapësirat e pastra, të sigurta (të shëndetshme) dhe anasjellas në mjedisin që e rrethon dhe tregon të paktën një mënyrë të veprimit për mbikëqyrje apo për përmirësim të gjendjes.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> 1.1. Vizaton, ngjyros e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në temë të caktuar. 2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik nxënësit/et njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse. 4. 2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Teknika e shtypit (II)		<b>Fjalët kyçe:</b> teknika e shtypit, ngjyrat e ujit, pema simboli i miqësisë.	
<b>Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Përzgjedh pemën si simbolin e miqësisë dhe shenjë e dorës së tij/saj si pjesë e rëndësishme e kësaj miqësie. - Realizon pemën e miqësisë nëpërmjet teknikës së shtypit duke përdorur dorën si model (shenjë). - Vlerëson kontributin e tij/saj për krijimin e pemës së miqësisë dhe kontributin e çdo anëtari të klasës.			
<b>Kriteret e suksesit:</b> - Bashkëpunon me shokët dhe shoqet e klasës për të realizuar detyrën. - Zgjedh ngjyrën sipas dëshirës. - Përdor teknikën e shtypit dhe dorën si model.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, dy tabakë letre (A4), ngjyra uji, penel.		<b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> Fusha: Shkencat shoqërore, Shkencat natyrore, Gjuha dhe komunikimi, Puna dhe jeta.	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Brainstorming (bashkëbisedim)**

Mësuesi/ja shkruan në tabelë emrin “Miqësia” dhe pyet nxënësit/et: Çfarë është për ju miqësia?

Mendimet që pasojnë këtë fjalë mund të jenë nga më të ndryshmet. Mësuesi/ja orienton diskutimin për të dalë në një përkufizim të tillë: Miqësia është dashuria, kujdesi dhe bashkëpunimi me shokët dhe shoqet.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Punë në grup**

Mësuesi/ja shpjegon: Ju në klasë jeni shokë e shoqe, ndihmoni, kujdeseni, bashkëpunoni dhe e doni njëri-tjetrit. Ju të gjithë jeni miq me njëri-tjetrit dhe jeni të gjithë të barabartë, por edhe të veçantë. Mësuesi/ja i orienton të ndërtojnë një pemë të miqësisë. Pema tregon që ata janë pjesë e një grupi, pra anëtarë të klasës së I-rë, ndërsa duart me ngjyra të ndryshme tregon që ata të gjithë janë të veçantë. Nxënësit/et realizojnë punën duke bashkëpunua me njëri-tjetrit dhe duke zbatuar rregullat e pastërtisë të vendosura nga mësuesi/ja. Këto rregulla janë: të mos bëjnë pis mjedisin dhe të lajnë duart sapo të mbarojnë punë.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi**

Kur mbaron puna secili nxënës vendos emrin te shenja e tij e dorës dhe shprehet se ai është pjesë e kësaj miqësie. Të gjithë nxënësit/et vlerësojnë bashkëpunimin me njëri-tjetrit.

**Vlerësimi i nxënësve**

**Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:**

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

**Detyrat dhe puna e pavarur**

Detyra zhvillohet në një fletë të madhe.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 25

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Arte	<b>Lënda:</b> Edukatë figurative	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> I	<b>Klasa:</b> I
<b>Gjuha dhe komunikimi artistik</b> <b>Tema:</b> Format dhe modelimi		<b>Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):</b> - Dallon dhe demonstroi shembuj për përbërjen dhe strukturën e formave (tredimensionale). - Përdor materiale të ndryshme (të lehta) për krijime modelimi (3 dimensionale).	
<b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b> IV.5. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë. IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj). III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> 2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit/et njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse. 1.1. Vizaton, ngjyros e modelon me laps, me ngjyra, me plastelinë, me letër e materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në temë të caktuar. 4.2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Forma tredimensionale		<b>Fjalët kyçe:</b> format gjeometrike dydimensionale, trupat gjeometrik ose format gjeometrike tredimensionale.	
<b>Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Identifikon figurat gjeometrike në lidhje me trupat gjeometrik përkatës. - Eksperimenton me letrën e sheshtë (dydimensionale) për të krijuar një formë të thjeshtë tredimensionale (cilindër, prizëm, aeroplan). - Shpjegon mënyrën e realizimit të aeroplanit me letër. <b>Kriteret e suksesit:</b> - Eksperimenton me letrën e sheshtë për të krijuar cilindrin dhe prizmin. - Realizon aeroplanin nëpërmjet palosjes.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, letër, laps, vizore, gërshërë.		<b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> Matematika, Gjuha dhe komunikimi, Puna dhe jeta.	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, hulumtimi i lirë**

Mësuesi/ja tregon disa nga trupat gjeometrikë dhe figurat gjeometrike përkatëse, si dhe i fton nxënësit/et të lidhin figurën me trupin përkatës (mësuesi/ja mund t'i referohet edhe figurës në libër).

**Ndërtimi i njohurive të reja: Demonstrim, hulumtim i orientuar**

Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se format gjeometrike janë dydimensionale (ato kanë gjerësi dhe lartësi) ndërsa trupat gjeometrikë janë tredimensionale (ata kanë lartësi, gjerësi dhe thellësi).

Për të kuptuar dallimin midis formës dy- dhe tredimensionale, mësuesi/ja demonstroi dhe i orientoi se si të kthejnë formën e sheshtë dydimensionale të letrës në një trup ose formë tredimensionale. Nëpërmjet rrotullimit të letrës (një mënyrë e thjeshtë), nxënësit/et krijojnë një cilindër. Nëpërmjet palosjes së letrës (në katër pjesë të barabarta, dy prej të cilave vendosen mbi njëra-tjetrën), nxënësit/et krijojnë një prizëm. Nëpërmjet palosjes, nxënësit/et ndjekin hapat për të krijuar një aeroplan.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Kllasteri (diskutim)**

Kur mbaron puna, mësuesi/ja vizaton një tabelë të thjeshtë të teknikës së kllasterit. Në krye vendos formën dhe e ndan me dy degëzime duke pyetur nxënësit/et: Si i ndajmë format sipas dimensioneve? Në dy drejtime vendos dydimensionale dhe tredimensionale. Nxënësit/et shpjegojnë mënyrën e realizimit të aeroplanit me letër. Ata vlerësojnë edhe punën e shokëve/shoqeve të klasës.

**Vlerësimi i nxënësve****Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:**

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

**Detyrat dhe puna e pavarur**

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te fletorja e punës e klasës së tretë.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 26

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Arte	<b>Lënda:</b> Edukatë figurative	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> I	<b>Klasa:</b> I
<b>Krijimtaria dhe performanca artistike</b> <b>Tema:</b> Forma dhe modelimi		<b>Rezultati i të nxëniet të temës (nga plani dymujor):</b> - Dallon dhe demonstroi shembuj për përbërjen dhe strukturën e formave (tredimensionale). - Përdor materiale të ndryshme (të lehta) për krijime modelimi (3 dimensionale).	
<b>Rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b> II.3. Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materialet e ndryshme ricikluese duke u mbështetur në imagjinatën e vet. IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/ aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj). III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/ aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> 1.1. Vizaton, ngjyros e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në temë të caktuar. 2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik nxënësit/et njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse. 4. 2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Forma dy- dhe tredimensionale (piramida)		<b>Fjalët kyçe:</b> piramida, forma dydimensionale, forma tredimensionale.	
<b>Rezultati/et e të nxëniet për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Përdor vijat dhe ngjyrat për të ngjyrosur faqet e piramidës në letër. - Pret me gërshërë modelin dydimensional të ngjyrosur dhe realizon me ngjitje piramidën. - Shpjegon mënyrën e realizimit të piramidës me letër. <b>Kriteret e suksesit:</b> - Përdor vija dhe ngjyra për të ngjyrosur faqet e piramidës. - Pret me gërshërë modelin dydimensional të piramidës nga fletorja e punës. - Realizon me palosje dhe ngjitje piramidën.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, letër me skemën e piramidës, lapsa me ngjyra ose flamastera, gërshërë, ngjitës.		<b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> Matematika, Gjuha dhe komunikimi, Puna dhe jeta.	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			



**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Bashkëbisedim**

Mësuesi/ja i pyet nxënësit/et se si i realizuan cilindrin dhe prizmin me letër? Pasi nxënësit/et shpjegojnë rrugën se si e kthyen letrën në një trup gjeometrik, mësuesi/ja nxjerr trupin gjeometrik të piramidës (një shembull i realizuar me letër, ose i referohet figurës në libër) dhe pyet nxënësit/et: A është kjo një piramidë e realizuar me letër?

**Ndërtimi i njohurive të reja: Demonstrim, punë individuale**

Mësuesi/ja shpërndan formatin e gatshëm të fotokopjuar të piramidës (në dy dimensione) dhe u shpjegon nxënësve se do të krijojnë piramidën.

Në fillim, mësuesi/ja i orienton të zbukurojnë me lloje të ndryshme të vijave (për të kujtuar njohuritë mbi vijën) dhe me ngjyra të ndryshme, faqet e prizmit. Më pas, i orienton të presin me gërshërë, në vendet e duhura, piramidën në formë të sheshtë. Sipas udhëzimeve, nxënësit/et palosin dhe ngjisin pjesët e duhura për të krijuar piramidën (mësuesi/ja qëndron pranë për të dhënë ndihmën e nevojshme).

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutim**

Kur mbaron puna, nxënësit/et shpjegojnë vijat dhe ngjyrat që përdorën për piramidën e tyre. Ata shpjegojnë edhe vështirësitë që hasën në realizimin e piramidës.

**Vlerësimi i nxënësve**

**Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:**

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

**Detyrat dhe puna e pavarur**

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te fletorja e punës e klasës së tretë.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 27

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Arte	<b>Lënda:</b> Edukatë figurative	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> I	<b>Klasa:</b> I
<b>Krijimtaria dhe performanca artistike</b> <b>Tema:</b> Forma dhe modelimi		<b>Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):</b> - Dallon dhe demonstroi shembuj për përbërjen dhe strukturën e formave (tredimensionale). - Njih dhe përdor mjete të modelimit (plastelinë).	
<b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b> II.3. Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materialet e ndryshme ricikluese duke u mbështetur në imagjinatën e vet. IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/ aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj). III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/ aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> 1.1. Vizaton, ngjyros e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në temë të caktuar. 2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik nxënësit/et njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse. 4.2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Trupat gjeometrikë me plastelinë		<b>Fjalët kyçe:</b> kubi, sfera, drejtkëndëshi, piramida, cilindri, plastelina.	
<b>Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Emërton trupat gjeometrikë. - Realizon kubin, sferën, piramidën, drejtkëndëshin etj., me plastelinë. - Shpjegon mënyrën e realizimit të trupave gjeometrik nëpërmjet plastelinës. <b>Kriteret e suksesit:</b> - Modelon plastelinën për të krijuar trupa gjeometrikë. - Realizon kubin, sferën, piramidën dhe drejtkëndëshin.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, modele të trupave gjeometrikë dhe plastelinë.		<b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> Matematika, Gjuha dhe komunikimi, Puna dhe jeta.	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim**

Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të emërtojnë trupat gjeometrikë. Përdor trupat gjeometrikë të matematikës dhe më pas i fton nxënësit/et të plotësojnë në libër.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Bisedë, punë individuale**

Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të realizojnë disa trupa gjeometrikë. Përpara se të fillojnë realizimin e çdo trupi gjeometrik, mësuesi/ja diskuton për karakteristikat e secilit p.sh., kubi ka gjashtë faqe të barabarta dhe është e ngjashme me katrorin si figurë; piramida e ka faqen e bazës katrore dhe formohet edhe nga katër faqe trekëndëshe; sfera është e rrumbullakosur njësoj dhe ka si figurë rrethin etj.

Nxënësit/et realizojnë me radhë trupat gjeometrikë me plastelinë duke u mbështetur te karakteristikat e tyre.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi**

Kur mbaron puna, nxënësit/et shpjegojnë trupat gjeometrikë që krijuan dhe karakteristikat e tyre. Ata diskutojnë se cili nga trupat ishte më i vështirë për t'u realizuar. Nxënësit/et vlerësojnë edhe punimet e shokëve dhe shoqeve të klasës.

**Vlerësimi i nxënësve**

**Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:**

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

**Detyrat dhe puna e pavarur**

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 28

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Arte	<b>Lënda:</b> Edukatë figurative	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> I	<b>Klasa:</b> I
<b>Gjuha dhe komunikimi artistik</b> <b>Tema:</b> Format dhe modelimi		<b>Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):</b> - Kupton dhe tregon vendosjen e formave në hapësirë. - Dallon format sipas madhësive dhe largësisë (perspektiva).	
<b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b> II.4. Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi/ja duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre. IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj). III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> 2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit/et njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse. 1.1. Vizaton, ngjyros e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në temë të caktuar. 4.2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Hapësira		<b>Fjalët kyçe:</b> hapësira, e madhe e vogël, afër, larg.	
<b>Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Zbulon mënyrën e paraqitjes së trupave në hapësirë (afër dhe larg). - Realizon një objekt në hapësirë duke ndjekur rregullin e objekteve afër dhe larg. - Shpjegon mënyrën e realizimit të krimbit në hapësirë. <b>Kriteret e suksesit:</b> - Pret nga fletorja e punës rrathët e madhësive të ndryshme. - Rendit rrathët nga më i madhi deri te më i vogli. - I ngjit rrathët duke u dhënë formën e një krimbi në lëvizje.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, imazhe që tregojnë vendosjen afër dhe larg të trupave të thjeshta në hapësirë, letër e modeluar, gërshërë, letra me ngjyra. ngjites.		<b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> Shkencat natyrore, Matematika, Gjuha dhe komunikimi, Puna dhe jeta.	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			
<b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore (bashkëbisedim)</b> Mësuesi/ja tregon një imazh që paraqet objekte të thjeshta të vendosur afër dhe larg në hapësirë (mësuesi/ja mund t'i referohet edhe imazhit të librit). Mësuesi/ja i orienton nxënësit/et të vëzhgojnë imazhin dhe të gjejnë cila është sfera më e madhe dhe cila është më e vogël. A vinë sferat duke u zvogëluar nga sfera më e madhe që është përpara deri tek ajo e fundit që shfaqet më e vogël?			

### **Ndërtimi i njohurive të reja: Bisedë, eksperimenti, punë individuale**

Pasi mbaron bashkëbisedimi me nxënësit/et, mësuesi/ja shpjegon se sferat në të vërtetë janë të barabarta, por ne do të zbulojmë përse nuk duken njësoj.

- Sferat janë të vendosura njëra pas tjetrës në hapësirë.

- Hapësira është sipërfaqja ku qëndrojnë objektet.

- Sfera më e madhe është më përpara, pra afër syrit tonë, ato mbrapa vijnë duke u zvogëluar, pra largohen nga syri ynë.

Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të realizojnë një krimb në hapësirë. Ai/a jo ndan letrat e fotokopjuara (në letër me ngjyra) nga libri dhe i udhëzon ata. Fillimisht, mësuesi/ja shpjegon që rrathët duhen prerë. Më pas, mësuesi/ja i pyet si mendoni t'i vendosni rrathët që përbëjnë krimbin, që ai të duket një krimb që lëviz në hapësirë? Kjo pyetje i nxit nxënësit/et që ta zgjidhin vetë problemin e vendosjes së pjesëve të krimbit në hapësirë. Mësuesi/ja vëzhgon, orienton dhe ndërhyr për ndihmë kur e sheh të nevojshme.

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi**

Kur mbaron puna, nxënësit/et shpjegojnë se si i vendosën pjesët e krimbit në hapësirë dhe pse. Ata vlerësojnë edhe punimet e shokëve dhe shoqeve të klasës.

### **Vlerësimi i nxënësve**

#### **Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:**

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;

- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

### **Detyrat dhe puna e pavarur**

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te fletorja e punës e klasës së tretë.

### **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 29

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Arte	<b>Lënda:</b> Edukatë figurative	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> I	<b>Klasa:</b> I
<b>Relacioni art-shoqëri Tema:</b> Objekte dhe artefakte		<b>Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):</b> - Njeh dhe dallon objekte të trashëgimisë kulturore (kombëtare dhe të kulturave të tjera). - Njeh disa nga objektet arkitekturale, qilimat, ornamentet, vazot etj.	
<b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b> II.4. Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre. IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/ aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj). III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/ aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> 3.1. Vëren dhe identifikon lloje të ndryshme të arteve. 1.1. Vizaton, ngjyros e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në temë të caktuar. 4. 2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Tradita e poçerisë		<b>Fjalët kyçe:</b> poçeri, enë, vazo, tradita, argjila, plastelina.	
<b>Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Zbulon teknikën e poçerisë si një traditë të hershme në vendin tonë. - Realizon një enë të thjeshtë me plastelinë duke ndjekur hapat e duhur. - Shpjegon mënyrën e realizimit të enës dhe hapat që ndoqi. <b>Kriteret e suksesit:</b> - Modelon plastelinën duke ndjekur hapat e duhur. - Krijon një enë të thjeshtë me plastelinë.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, imazhe vazove antike qeramike të gjetura në Kosovë, imazhe të vazove tradicionale të ditëve të sotme, imazhe që tregojnë procesin e punimit të poçerisë.		<b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> Fusha: Shkencat natyrore, Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Gjuha dhe komunikimi.	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bashkëbisedim**

Mësuesi/ja shfaq imazhe të vazove antike dhe të ditëve të sotme (ose i referohet imazheve në libër) dhe drejton pyetje të tilla: Me çfarë materiali mendoni se janë krijuar vazot? A ke parë enë të ngjashme në shtëpinë tënde? Po në zonën ku banon a diku tjetër?

**Ndërtimi i njohurive të reja: bisedë, demonstrim, punë individuale**

Më pas, mësuesi/ja shpjegon që punimi i enëve është një traditë e hershme në vendin tonë. Ajo vazhdon edhe sot. Materiali që përdoret për prodhimin e enëve quhet argjilë.

**Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të krijojnë një enë me plastelinë sipas traditës së poçerisë.**

Mësuesi/ja demonstroi hap pas hapi mënyrën e realizimit të enës. Edhe pse nxënësit/et ndjekin demonstrimin e mësuesit/es ose hapat në libër, ata mund të improvizojnë edhe vetë realizimin e enës, si në elemente shtesë apo edhe në formë. Në këto, raste mësuesi/ja i inkurajon që të jenë sa më kreativ në realizimin e enës së tyre.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi**

Kur mbaron puna, nxënësit/et shpjegojnë se si e realizuan enën e tyre. Ata tregojnë nëse i ndenjin besnik modelit të dhënë apo i dhanë vazos formën e dëshiruar. Ata vlerësojnë edhe punimet e shokëve dhe shoqeve të klasës.

**Vlerësimi i nxënësve**

**Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:**

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

**Detyrat dhe puna e pavarur**

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 30

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
<b>Relacioni art-shoqëri Tema:</b> Objekte dhe artefakte		<b>Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Njeh dhe dallon objekte të trashëgimisë kulturore (kombëtare dhe të kulturave të tjera).</li> <li>- Njeh disa nga objektet arkitekturale, qilimat, ornamentet, vazot etj.</li> <li>- Komenton punimet personale dhe i krahason me punimet e tjera në klasë.</li> </ul>	
<b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b> <p>II.4. Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi/ja duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitën që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre.</p> <p>IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/ aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).</p> <p>III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në një material tjetër për të realizuar një veprim/ aktivitet/ detyrë që kërkohet prej tij/saj.</p>			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> <p>3.1. Vëren dhe identifikon lloje të ndryshme të arteve.</p> <p>1.1. Vizaton, ngjyros e modelon me laps, me ngjyra, me plastelinë, me letër e materiale të tjera, në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në temë të caktuar.</p> <p>4.2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.</p>			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Mozaiku		<b>Fjalët kyçe:</b> mozaik, gurë shumëngjyrësh	
<b>Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Zbulon teknikën e mozaikut si një traditë të hershme romake. <ul style="list-style-type: none"> <li>- Realizon një punim në mozaik nëpërmjet farave të ndryshme me ngjyra.</li> <li>- Shpjegon mënyrën e realizimit të mozaikut dhe farat që përdori.</li> </ul> <b>Kriteret e suksesit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përgatit vizatimin me figurën e zogut.</li> <li>- Përgatit farat sipas ngjyrave dhe ngjitesin.</li> <li>- Realizon mozaikun nëpërmjet ngjitjes së farave në hapësirat e caktuara të vizatimit.</li> </ul>			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, imazh i një mozaiku romak, fletë vizatimi, fara me ngjyra të ndryshme, laps, ngjitës.		<b>Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/ apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> Fusha: Shkencat shoqërore, Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Gjuha dhe komunikimi.	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			
<b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore (bashkëbisedim)</b> Mësuesi/ja shfaq imazhin e një mozaiku romak ose i referohet imazhit në libër ku paraqitet një zog. I orienton nxënësit/et ta vëzhgojnë dhe ta përshkruajnë se çfarë paraqet. Më pas, i fton të identifikojnë ngjyrat e përdorura në të.			



**Ndërtimi i njohurive të reja: Bisedë, demonstrim, punë individuale**

Mësuesi/ja shpjegon se romakët krijojnë mozaikë me gurë shumëngjyrësh dhe copa xhami. Me mozaikët, ata zbukuronin dyshemetë dhe muret e shtëpive. Ata kanë paraqitur shumë figura kafshësh në mozaikët e tyre.

Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të krijojnë një zog në teknikën e mozaikut, nëpërmjet përdorimit të farave me ngjyra. Në fillim, nxënësit/et vizatojnë zogun në fletë e pastaj përdorin farat e ndryshme duke i ngjitur.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi**

Kur mbaron puna, nxënësit/et shpjegojnë se si e realizuan mozaikun e tyre. Ata tregojnë për llojet e farave dhe të ngjyrave që përdorën. Ata vlerësojnë edhe punimet e shokëve dhe shoqeve të klasës.

**Vlerësimi i nxënësve**

**Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:**

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

**Detyrat dhe puna e pavarur**

Detyra zhvillohet në fletë ose në fletoren e vizatimit.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 31

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Arte	<b>Lënda:</b> Edukatë figurative	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> I	<b>Klasa:</b> I
<b>Relacioni art-shoqëri Tema:</b> Krijues të shquar		<b>Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):</b> - Njeh ndonjë krijues (vizatues, piktor, skulptor, arkitekt etj.), të shquar nga vendi dhe bota. - Komenton punimet personale dhe i krahason me punimet e tjera në klasë.	
<b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b> III.1. Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjat, ngjyrat, numërorin etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë. III.7. Identifikon njohuritë që ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuara dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive. III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/ aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> 3.3. Emërton disa (së paku 4 krijues), interpretues të njohur të gjinive e zhanreve të ndryshme të krijimtarisë artistike globale e kombëtare. 1.1. Vizaton, ngjyros e modelon me laps, me ngjyra, me plastelinë, me letër e materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në temë të caktuar. 4. 2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Lulet e diellit sipas Van Gogut		<b>Fjalët kyçe:</b> Krijues të shquar, natyrë e qetë	
<b>Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Njeh artistin e shquar Van Gog dhe karakteristikat e veprës së tij “Lulet e diellit”. - Realizon një punim në kolazh duke u mbështetur në veprën “Lulet e diellit” të Van Gogut. - Shpjegon mënyrën e realizimit të natyrës së qetë “Vazo me lule” nëpërmjet teknikës së kolazhit. <b>Kriteret e suksesit:</b> - Zgjedh letrat me ngjyra për vazon dhe për lulet. - Vizaton vazon dhe petalet e luleve dhe i pret me gërhërë. - Ngjit letrat e prera (vazon dhe petalet) mbi letrën me ngjyrë.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, imazh “lulet e diellit” e Van Gogut, Letra me ngjyra, laps, gërhërë, ngjitës.		<b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> Fusha: Shkencat shoqërore, Shoqëria dhe mjedisi, Gjuha dhe komunikimi.	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim**

Mësuesi/ja shfaq imazhin e veprës “Lulet e diellit” të Van Gogut ose i referohet imazhit në libër dhe shpjegon që kjo është një vepër shumë e njohur e artistit të shquar holandez Van Gog. Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të vëzhgojnë me vëmendje veprën e Van Gogut dhe drejton pyetjet: Çfarë ngjyre ka përdorur Van Gogu për sfondin (hapësirën pas luleve)?

Po për lulet dhe vazon?

**Ndërtimi i njohurive të reja: Bisedë, demonstrim, punë individuale**

Mësuesi/ja shpjegon se piktori holandez Vinsent Van Gog (1853-1890) është shumë i njohur për përdorimin e ngjyrave të forta në pikturat e tij.

Kjo vepër i përket gjinisë së natyrës së qetë. Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të realizojnë një pikturë (natyrë të qetë) me lule dielli, duke u mbështetur në veprën e Van Gogut. Mësuesi/ja i orienton ata që ta realizojnë këtë detyrë nëpërmjet kolazhit. Mësuesi/ja shpjegon dhe demonstroi hapat që duhet të ndjekin fëmijët, por gjithmonë duke nxitur improvizimin dhe zgjidhjen e lirë të nxënësve. P.sh., çdo nxënës mund t’i japë formën e dëshiruar vazos së tij/saj; të zgjedhë të bëjë një lule dielli ase dy; të përzgjedhë ngjyrat sipas dëshirës; petalet t’i bëjë me prerje apo me grisje; të përzgjedhë numrin e petaleve etj.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi**

Kur mbaron puna, nxënësit/et shpjegojnë se si e realizuan punimin e tyre në kolazh. Ata tregojnë për ngjyrat që zgjedhën dhe vështirësitë që hasën. Nxënësit/et krahasojnë punimin e tyre me atë të Van Gogut dhe me punimet e shokëve të klasës. Edhe pse ata u mbështetën te vepra e Van Gogut çdo punim është i veçantë.

**Vlerësimi i nxënësve**

**Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:**

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

**Detyrat dhe puna e pavarur**

Detyra zhvillohet në fletë ose në fletoren e vizatimit.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 32

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
<b>Relacioni art-shoqëri Tema:</b> Krijues të shquar		<b>Rezultati i të nxënit të temës</b> (nga plani dymujor): - Njeh ndonjë krijues (vizatues, piktor, skulptor, arkitekt etj.), të shquar nga vendi dhe bota. - Komenton punimet personale dhe i krahason me punimet e tjera në klasë.	
<b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b> III.1. Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjë, ngjyrat, numërorin etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyetën zgjedhjen që ka bërë. III.7. Identifikon njohuritë që ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive. III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/ aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> 3.3. Emërton disa (së paku 4 krijues, interpretues të njohur të gjinive e zhanreve të ndryshme të krijimtarisë artistike globale e kombëtare. 1.1. Vizaton, ngjyros e modelon me laps, me ngjyra, me plastelinë, me letër e materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në temë të caktuar. 4. 2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Peizazh vjeshte sipas Ismail Lulanit		<b>Fjalët kyçe:</b> krijues të shquar, peizazh.	
<b>Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Njeh artistin e shquar Ismail Lulani dhe karakteristikat e veprës së tij “Peizazh vjeshte”. - Realizon një peizazh vjeshte në teknikën e shtypit me gjethe duke u mbështetur në veprën e Ismail Lulanit. - Shpjegon mënyrën e realizimit të peizazhit nëpërmjet teknikës së shtypit. <b>Kriteret e suksesit:</b> - Zgjedh gjethet dhe ngjyrat e duhura për vjeshtën. - Përgatit ngjyrat në një pjatë. - Realizon peizazhin nëpërmjet teknikës së shtypit.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, imazh i peizazhit të Ismail Lulanit, letër vizatimi, gjethe të ndryshme, ngjyra uji.		<b>Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> Fusha: Shkencat natyrore, Shoqëria dhe mjedisi, Gjuha dhe komunikimi	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore (bashkëbisedim)**

Mësuesi/ja shfaq imazhin e veprës “Peizazh vjeshte” të Ismail Lulanit ose i referohet imazhit në libër dhe shpjegon që kjo është një vepër e artistit të njohur shqiptar Ismail Lulanit. Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të vëzhgojnë me vëmendje veprën e artistit dhe drejton pyetjet:

Cila stinë mendoni se është paraqitur në këtë peizazh? Pse? Po sfondi çfarë ngjyre ka? Po pemët?

**Ndërtimi i njohurive të reja: Bisedë, demonstrim, punë individuale**

Mësuesi/ja shpjegon se piktori Ismail Lulani lindi në Tuz të Malit të Zi dhe punoi e jetoi në qytetin e Shkodrës. Ai shquhet për stilin e tij të veçantë dhe pasurinë e ngjyrave në pikturat e tij.

Kjo vepër i përket gjinisë së peizazhit. Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të realizojnë një peizazh vjeshte, duke u mbështetur në veprën e Ismail Lulanit. Mësuesi/ja i orienton nxënësit/et ta realizojnë këtë detyrë nëpërmjet shtypit me gjethe (Forma e gjetheve duket e përshtatshme dhe është një mënyrë e thjeshtë për të imituar atë të pemëve). Mësuesi/ja shpjegon dhe demonstroi hapat që duhet të ndjekin fëmijët, por gjithmonë duke nxitur improvizimin dhe zgjidhjen e lirë të nxënësve.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi**

Kur mbaron puna, nxënësit/et shpjegojnë se si e realizuan peizazhin e vjeshtës. Ata tregojnë për ngjyrat dhe llojet e gjetheve që zgjodhën. Nxënësit/et krahasojnë punimin e tyre me atë të Ismail Lulanit dhe me punimet e shokëve të klasës. Edhe pse ata u mbështetën në peizazhin e artistit, çdo punim është i veçantë.

**Vlerësimi i nxënësve**

**Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:**

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

**Detyrat dhe puna e pavarur**

Detyra zhvillohet në fletë ose në fletoren e vizatimit.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 33

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Arte	<b>Lënda:</b> Edukatë figurative	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> I	<b>Klasa:</b> I
<b>Relacioni art-shoqëri</b> <b>Tema:</b> Krijues të shquar		<b>Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):</b> - Njeh ndonjë krijues (vizatues, piktor, skulptor, arkitekt etj.), të shquar nga vendi dhe bota. - Komenton punimet personale dhe i krahason me punimet e tjera në klasë.	
<b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b> III.1. Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjë, ngjyrat, numërorin etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë. III.7. Identifikon njohuritë që ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive. III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/ aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> 3.3. Emërton disa (së paku 4 krijues), interpretues të njohur të gjinive e zhanreve të ndryshme të krijimtarisë artistike globale e kombëtare. 1.1. Vizaton, ngjyros e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në temë të caktuar. 4.2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të të tjerëve, duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Kulla sipas Muslim Mulliqit		<b>Fjalët kyçe:</b> krijues të shquar, kulla.	
<b>Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Njeh artistin e shquar Muslim Mulliqi dhe karakteristikat e veprës së tij “Kulla”. - Realizon një kullë duke u mbështetur në veprën e artistit Muslim Mulliqi. - Shpjegon mënyrën e realizimit të kullës dhe teknikën që e realizoi. <b>Kriteret e suksesit:</b> - Vizaton kullën me elementet përkatëse, derën, dritaret, pemët përreth. - Zgjedh teksturë për çdo pjesë të Kullës. - Përdor lapsa me ngjyra ose pastela për të realizuar teksturat me ngjyra.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, imazh i pikturës së artistit Muslim Mulliqi, letër vizatimi, tekstura të ndryshme, laps, pastela.		<b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> Fusha: Shkencat natyrore, Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Gjuha dhe komunikimi.	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim**

Mësuesi/ja shfaq imazhin e veprës “Kulla” të artistit Muslim Mulliqi, ose i referohet imazhit në libër dhe shpjegon që kjo është një vepër e artistit të shquar Muslim Mulliqit. Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të vëzhgojnë me vëmendje veprën e artistit dhe drejton pyetjet: Çfarë karakteristikash kanë kullat? Me çfarë materiali janë ndërtuar ato?

**Ndërtimi i njohurive të reja: Bisedë, demonstrim, punë individuale**

Mësuesi/ja shpjegon se piktori Muslim Mulliqi lindi në Gjakovë. Në krijimtarinë e tij, ai pasqyroi motive dhe imazhe nga Kosova. Kulla është një nga motivet simbolike të veprës së tij.

Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të realizojnë edhe ata një kullë, duke u mbështetur në veprën e Muslim Mulliqit. Mësuesi/ja tregon imazhe fotografike të kullave dhe i orienton nxënësit/et ta realizojnë këtë detyrë nëpërmjet teksturave të ndryshme. Tekstura e materialeve që përdoren për ndërtimin e kullave janë shumë të dukshme si p.sh., guri apo rrasat ose tjegullat e çatisë. Pasi vizatojnë kullën, nxënësit/et duhet të përshtatin teksturën e objekteve dhe ta kalojnë imazhin e tyre nëpërmjet fërkimit në pjesën e duhur. Për shembull, ata përshtatin teksturën për muret e gurit, për çatinë, për derën dhe dritaret, për tokën, për bimësinë etj., si edhe ngjyrat. Mësuesi/ja shpjegon dhe demonstroi hapat që duhet të ndjekin fëmijët, por gjithmonë duke nxitur improvizimin dhe zgjidhjen e lirë të nxënësve.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi**

Kur mbaron puna, nxënësit/et shpjegojnë se si e realizuan Kullën. Ata tregojnë për teksturat që zgjodhën dhe ngjyrat. Nxënësit/et krahasojnë punimin e tyre me atë të Muslim Mulliqit dhe me punimet e shokëve të klasës. Edhe pse ata u mbështetën në peizazhin e artistit, çdo punim është i veçantë.

**Vlerësimi i nxënësve**

**Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:**

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

**Detyrat dhe puna e pavarur**

Detyra zhvillohet në fletë ose në fletoren e vizatimit.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 34

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
<b>Çmuarja dhe vlerësimi estetiko-artistik</b> <b>Tema:</b> Përshkrimi, analiza dhe vlerësimi i punimeve		<b>Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):</b> - Përshkruan punimet me shkrim (së paku 2 fjali). - Komenton dhe krahason vepra të artit dhe punimet e nxënësve. - Përjeton dhe vlerëson në mënyrë personale (së paku 2 punime). - Çmon dhe vlerëson imagjinatën kreative të punimeve.	
<b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b> III.3.Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit. III.7. Identifikon njohuritë që ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive. VI.6.Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët përmënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> 1.1. Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike, me disa fjali të thjeshta, gjatë bisedës dhe vrojtimit, me lëvizje, mimikë, me mjete shprehëse të tjera etj. 4. 2. Çmon dhe vlerëson performancën/krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve me fjalor shumë të thjeshtë (p.sh. ai/a jo këndoi mirë, pastër, më pëlqejnë ngjyrat që ke përdorur, nuk e ke vizatuar mirë formën e topit etj.).			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Krahasojmë dy vepra arti <sup>3</sup>		<b>Fjalët kyçe:</b> përshkrim, krahasim, vepra arti	
<b>Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Vëzhgon dy vepra arti dhe përshkruan çfarë sheh në to. - Analizon dhe krahason elementet e subjektit që paraqesin veprat e artit. - Vlerëson veprat duke renditur karakteristikat e veçanta dhe ato të përbashkëtat.			
<b>Kriteret e suksesit:</b> - Përshkruan dhe krahason atë që sheh te dy vepra arti. - Rendit karakteristikat e veçanta dhe të përbashkëta të dy veprave të artit.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, imazhet e dy veprave të artit që kanë elemente të përbashkëta të subjektit.		<b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> Shkencat natyrore, Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Gjuha dhe komunikimi.	
<b>Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore</b>			

<sup>3</sup> Hapësira është sipërfaqja ku qëndrojnë objektet.



**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, përshkrimi**

Mësuesi/ja shfaq imazhet e dy veprave që kanë karakteristika të përbashkëta të subjektit. Në libër janë marrë si shembull: “Një ditë e diel në parkun buzë lumit në Paris”, 1884, e artistit Xhorxh Sera dhe “Ditë me shi në Paris”, 1877, e artistit Gustav Kailebot. Nxënësit/et ftohen të përshkruajnë subjektin e veprës së artit, pra atë që është e dukshme. Nxënësit/et përshkruajnë mjedisin, motin, veprimet e njerëzve, ngjyrat, stinën etj.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, analiza dhe krahasimi**

Mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të analizojnë: ngjyrat e pikturave (në pikturën e parë ngjyrat janë të ndritshme dhe ato tregojnë për një ditë me diell, ndërsa në pikturën e dytë ngjyrat janë gri dhe tregojnë një ditë pa diell dhe me shi); teksturën (përmendim këtu që piktura e Xhorxh Sera është një pikturë pointiliste me pika dhe piktura e Gustav Kaleibot paraqet një teksturë reale); veshjen (në pikturën e parë veshja tregon për një stinë të ngrohtë vere, ndërsa në të dytën veshja tregon për një ditë të ftohtë dimri); objekti i çadrës (çadra në pikturën e parë përdoret për t’u mbrojtur nga dielli, ndërsa në pikturën e dytë përdoret për t’u mbrojtur nga shiu).

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Vlerësimi, diagrami i venit**

Mësuesi/ja ndërton në tabelë diagramin e Venit dhe vendos karakteristikat e veçanta të secilës pikturë sipas analizës krahasuese të bërë më parë. Për të plotësuar tabelën e mesit, e cila përmban karakteristikat e përbashkëta, mësuesi/ja fton nxënësit/et të japin mendimin e tyre. Në bazë të viteve të realizimit të punëve, nxënësit/et dalin në mendimin se veprat i përkasin së njëjtës periudhë historike. Gjithashtu, stili i veshjes është i njëjtë edhe pse stinët janë të ndryshme. Çadra përdoret te të dyja pikturat, por për qëllime të ndryshme.

**Vlerësimi i nxënësve****Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:**

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

**Detyrat dhe puna e pavarur****Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 35

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Arte	<b>Lënda:</b> Edukatë figurative	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> I	<b>Klasa:</b> I
<b>Relacioni art-shoqëri Tema:</b> Galeri dhe ekspozime		<b>Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):</b> - Njeh dhe kupton disa nga institucionet kulturoro-artistike (muzeume, galeri, studio, vende arkeologjike etj.)	
<b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b> III.3.Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit. V.5. Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj. VI.6.Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> 1.1 Vëren dhe identifikon lloje të ndryshme të arteve. 1.2 Vëren dhe identifikon llojet e institucioneve artistike. 4. 2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Vizitë në studion e piktorit <sup>4</sup>		<b>Fjalët kyçe:</b> artist, studio, krijimtari	
<b>Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Zbulon se vendi ku artistët punojnë dhe krijojnë quhet studio. - Parashtron pyetje për mjetet e punës dhe mënyrën se si krijon një artit. - Shpreh mendimin e tij mbi profesionin e artistit. <b>Kriteret suksesit:</b> - Përshkruan karakteristikat e punës së artistëve figurativë. - Përshkruan vendin e punës së artistëve figurativë.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Edukatë figurative I, imazhe të artistëve në studiot e tyre gjatë procesit të punës krijuese ose vizitë në studion e ndonjë artisti.		<b>Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Gjuha dhe komunikimi	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			
<b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Brainstorming</b> Mësuesi/ja shkruan në dërrasën e zezë fjalën “artist” dhe i fton nxënësit/et të japin idetë dhe perceptimin e tyre mbi këtë fjalë. Mësuesi/ja vendos rreth fjalës artist të gjitha fjalët që fëmijët i lidhin me të, pa paragjykuar asnjërin. Ndër to mund të jenë: piktor, skulptor, këngëtar, krijues, aktor, dizajn etj. Nxënësit/et orientohen të flasin rreth profesioneve artistike të artit figurativ.			

4 Ky model mësimi me rrugën metodike që ndjek, shërben për të krahasuar dy punime të nxënësve në klasë apo edhe vepra të tjera të artit.

### **Ndërtimi i njohurive të reja: Bisedë, kujtesa pamore**

Mësuesi/ja shpjegon se ata do të diskutojnë së bashku rreth artistëve të artit figurativ dhe vendit të tyre të punës. Vendi ku artistët krijojnë dhe punojnë quhet studio. Në imazhet e librit shfaqet artistja meksikane, Frida Kahlo (1907-1954) duke pikturuar në studion e saj dhe artistja Alije Vokshi (1945-2022) duke punuar në studion e saj.

Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të identifikojnë objektet dhe mjetet e punës në studiot e artistëve. Gjithashtu, mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të parashtrajnë pyetje rreth mënyrës së punës së artistëve dhe studios së tyre. Mësuesi/ja shpjegon rreth mjeteve që artistët përdorin sipas drejtimit të tyre artistik (piktorë, skulptorë, grafistë, artistë të arteve të aplikuara etj.); rreth hapësirave të studios etj. Mësuesi/ja shpjegon që përveç mjeteve të punës, artistët mbajnë në studiot e tyre edhe libra që kanë informacione për artin, etj.

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi**

Në fund të orës, nxënësit/et vlerësojnë punën e artistëve. Ata shpjegojnë përse u nevojitet artistëve hapësira e punës që quhet studio. Nxënësit/et krahasojnë punën e tyre në klasë dhe mjetet e ndryshme që përdorin për krijimet e tyre. Disa nxënës mund të shprehin edhe dëshirën për t'u bërë artistë kur të rriten.

### **Vlerësimi i nxënësve**

#### **Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:**

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

### **Detyrat dhe puna e pavarur**

### **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 36

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Arte	<b>Lënda:</b> Edukatë figurative	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> I	<b>Klasa:</b> I
<b>Gjuha dhe komunikimi artistik</b> <b>Tema:</b> Profesionin im kur të rritem <sup>5</sup>		<b>Rezultati i të nxënësve të temës (nga plani dymujor):</b> - Realizon një punim për profesionin duke komentuar mënyrën e realizimit. - Shpjegon mënyrën e ndërlidhjes së lëndëve me punimin e realizuar.	
<b>Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës (të synuara):</b> III.1. Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjët, ngjyrat, numërorin etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë. III.7. Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuara dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive. VI.4. Identifikon vlera shoqërore që kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si, p.sh., besim, ndërsjellë, tolerancën, solidaritetin, respektin, mirësjelljen etj.). III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/ aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara).</b> 2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit/et njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse. 1.1. Vizaton, ngjyros e modelon me laps, me ngjyra, me plastelinë, me letër e materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në temë të caktuar. 4.2. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike personale dhe të tjerëve duke përdorur një fjalor shumë të thjeshtë.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
<b>Njësia mësimore:</b> Profesionin që më pëlqen më shumë		<b>Fjalët kyçe:</b> profesionin.	
<b>Rezultati/et e të nxënësve për orën mësimore</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - Njeh profesione të ndryshme dhe karakteristikat e tyre. - Realizon një punim mbi profesionin që pëlqen më shumë nëpërmjet një teknike të caktuar. - Shpjegon se si ka paraqitur mjetet e punës apo uniformën e profesionit në krijimin e tij/saj. <b>Kriteret e suksesit:</b> - Dallon karakteristikat e profesioneve të ndryshme. - Vizaton mjetet e punës dhe veshjen e një profesioni që i pëlqen.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Imazhe që ilustron profesione të ndryshme, fleta e vizatimit dhe mjetet e vizatimit.		<b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> Fusha: Shkencat natyrore, Shkencat shoqërore, Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Gjuha dhe komunikimi.	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			

<sup>5</sup> Kjo temë mësimore nuk pasqyrohet në libër, por nëpërmjet planifikimit të orës mësimore në librin e mësuesit. Në librin e artit figurativ janë realizuar qasje që kanë lidhje me profesione të artit figurativ, edhe me ato të arteve të aplikuara (dizajni, qeramika, dizajni i tekstileve).

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kllaster, bashkëbisedim**

Mësuesi/ja prezanton temën mësimore “Profesioni që më pëlqen më shumë”. Mësuesi/ja shkruan në dërrasë fjalën “Profesionet” dhe fton nxënësit/et të thonë emrin e profesionit që u pëlqen më shumë, pse u pëlqen dhe të përshkruajnë karakteristikat e profesionit. Rreth fjalës profesion, mësuesi/ja shkruan profesionet e ndryshme që emërtojnë nxënësit/et.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Bisedë, punë individuale**

Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të vizatojnë profesionin e tyre të parapëlqyer. Ai/ajo i orienton të paraqesin karakteristikat e profesionit nëpërmjet uniformës së tyre, mjeteve të punë që përdorin dhe mjedisit ku punojnë. Nxënësit/et zgjedhin vetë mjetet dhe teknikën për të realizuar punimin e tyre, Gjatë kohës së punës, mësuesi/ja i vëzhgon dhe orienton drejt punës ose iu përgjigjet pyetjeve të tyre.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi**

Kur mbaron puna, nxënësit/et shpjegojnë se si e realizuan punimin e tyre. Ata tregojnë si i kanë paraqitur karakteristikat e profesionit që kanë zgjedhur, mjetet e punës dhe mjedisin. Ata vlerësojnë edhe punimin e shokëve dhe shoqeve të klasës.

**Vlerësimi i nxënësve**

**Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:**

- në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit/et iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

**Detyrat dhe puna e pavarur**

Detyra zhvillohet në fletë ose në fletoren e vizatimit.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## REFERENCA

- *Kurrikula lëndore/programi mësimor: Edukatë figurative I; Republika e Kosovës, gusht, 2018.*
- *Udhëzues praktik për zbatimin e kurrikulës, fusha e kurrikulës Artet; Instituti Pedagogjik i Kosovës; Republika e Kosovës, mars 2014.*
- *Eileen S. Prince, Art Is Every Day, Activities for the Home, Park, Museum, and City, Zephyr Press, Chicago, 2012.*
- *Al Hurwitz&Michael Day, Children and Their Art: Methods for the Elementary School, Eighth Edition, Thomson Wadsworth, USA, 2007.*
- *Eileen S. Prince - Art is Fundamental. Teaching the Elements and Principles of Art in Elementary School; Zephyr Press, Chicago, 2008.*
- *Eileen S. Prince - Art Matters: Strategies, Ideas, and Activities to Strengthen Learning Across the Curriculum; Zephyr Press, Chicago, 2002.*
- *Rob Barnes - Teaching Art to Young Children 4-9; Routledge Falmer, London and New York, 2002.*
- *Angela Wenzel - 13 Art Techniques Children Should Know; Prestel Publishing, Munich-London-New York, 2013.*
- *Gaitskell, Charles D., Hurwitz, Al, Day, Michael - Children and Their Art: Methods for the Elementary School; Harcourt College Publishers, 1982.*
- *Rudolf Arnheim - Arte e percezione visiva; Feltrinelli Editore, 1994.*
- *<https://teachbesideme.Com/klee-art-lesson/>*  
*<https://kinderart.Com/category/art-lessons/painting/>*  
*<https://www.Artic.Edu/artworks/20684>*  
*[https://en.Wikipedia.Org/wiki/a\\_sunday\\_afternoon\\_on\\_the\\_island\\_of\\_la\\_grande\\_jatte](https://en.Wikipedia.Org/wiki/a_sunday_afternoon_on_the_island_of_la_grande_jatte)*
- *Fotografitë e marra nga faqja: <https://www.dreamstime.com/>*

